



INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT
INSTITUCIJA OMBUDSMANA
OMBUDSPERSON INSTITUTION

RAPORTI VJETOR I MKP 2022 NR. 6



Republika e Kosovës · Republika Kosovo · Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit · Institucija Ombudsmana · Ombudsperson Institution



RAPORT VJETOR I MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIM TË TORTURËS

Nr.6

Prishtinë, 2023

Përmbajtja

Fjala e Avokatit të Popullit	7
I. MEKANIZMI KOMBËTAR PËR PARANDALIM TË TORTURËS	10
Metodologjia e vizitave të MKP-së.....	11
Vizitat e realizuara gjatë vitit 2022	12
Bashkëpunimi me institucionet e vizituara	12
II. POLICIA E KOSOVËS	16
Keqtrajtimi fizik.....	16
Garancitë procedurale kundër keqtrajtimit fizik	17
Kushtet fizike të stacioneve policore të vizituara.....	18
Qendrat e mbajtjes dhe stacionet policore të vizituara gjatë vitit 2022.....	20
III. QENDRAT KORREKTUESE DHE TË PARABURGIMIT	22
Trajtimi	22
Incidentet ndërmjet të burgosurve	24
Kushtet e akomodimit në qendrat korrektuese dhe në qendra të paraburgimit	24
Regjimi për të dënuarit	28
Kontaktet me botën e jashtme	31
Procedura e parashtrimit të ankesave në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit	32
Kujdesi shëndetësor në qendrat korrektuese dhe në qendra të paraburgimit	32
Kontrollet mjekësore për të sapopranuarit	32
Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore.....	33
Ankesat lidhur me trajtimin mjekësor	33
Prezenca e të burgosurve me probleme mendore në qendrat korrektuese dhe në qendra të paraburgimit	33
Personeli i qendrave korrektuese dhe i qendrave të paraburgimit	34
Qendrat korrektuese dhe të paraburgimit të vizituara gjatë vitit 2022.....	35
IV. QENDRAT PËR AZILKËRKUES	38
MONITORIMI I OPERACIONEVE TË KTHIMIT ME FORCË PËRMES LINJAVE AJRORE	42
Qendrat e Mbajtjes për të Huaj dhe Qendra e Azilit të vizituara në vitin 2022.....	42
V. INSTITUCIONET E SHËNDETIT MENDOR DHE ATO TË KUJDESIT SOCIAL	44
Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës	44
Klinika e Psikiatrisë në Prishtinë - Reparti i Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik	47
QENDRAT E SHËNDETIT MENDOR DHE SHTËPITË INTEGRUESE NË BASHKËSI	51
Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmureve Kronikë Psikiatrikë në Shtime (QIRSKP)	52
INSTITUCIONET E KUJDESIT SOCIAL	54
Instituti Special në Shtime (ISSh), Shtëpia e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore në Shtime, Shtëpitë me Bazë në Komunitet (ShBK)	54
Vizita në Institutin Special në Shtime (ISSh)	54
Vizita në Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore në Shtime.....	55
Shtëpitë me Bazë në Komunitet (ShBK).....	56

Institucionet e Shëndetit Mendor të vizituara gjatë vitit 2022	58
VI. SHËPITË PËR PERSONAT E MOSHUAR DHE PA PËRKUJDESJE FAMILJARE	60
VII. AKTIVITETET DHE TAKIMET E MKP-së ME INSTITUCIONET KOMPETENTE GJATË VITIT 2022.....	66
Trajnimet për MKP-në gjatë vitit 2022	70
Bashkëpunimi ndërkombëtar i MKP-së 2022	70

Fjala e Avokatit të Popullit

Të nderuar,

Avokati i Popullit, duke rikujtuar nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, se “askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”¹, e me qëllim të përmbushjes të detyrimit të vet kushtetues e ligjor² si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e torturës, udhëhiqet edhe nga parimet dhe standardet e përcaktuara nga Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese dhe Protokollit i saj.

Në përmbushje të këtij detyrimi, që si qëllim ka mbikëqyrjen dhe mbrojtjen personave të privuar nga liria, kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese, fokus në vitin 2022 kemi pasur monitorimin e respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Kryesisht jemi përqendruar në monitorimin e institucioneve të kujdesit social dhe të shëndetit mendor, me qëllim të vëzhgimit të respektimit të të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen kësaj kategorie, duke adresuar rekomandime me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe trajtimit të tyre dhe sigurimin e plotë të të drejtave të njeriut.

Avokatit të Popullit, si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim, i garantohet ushtrimi i mandatit përmes realizimit të vizitave në çdo kohë, pa kufizim e pa paralajmërim, në të gjitha institucionet e vendit, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të ndaluar apo të arrestuar, të paraburgosur, në reparte ose në institucione shëndetësore, në spitale psikiatrike, në azile, në pika kufitare, në

aeroport, si dhe në çdo vend tjetër ku ka të dhëna dhe e vlerëson se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe të lirive të njeriut.

Ky Raport pasqyron punën e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të torturës dhe për qëllim ka informimin e autoriteteve publike dhe të qytetarëve për nivelin e respektimit të detyrimit që ka shteti për të siguruar që askush nuk duhet t’i nënshtrohet torturës apo trajtimit tjetër çnjerëzor e poshtërues. Gjithashtu Raporti paraqet të përmbledhura të gjeturat tona gjatë mbikëqyrjes së respektimit të detyrimit kushtetues e ligjor për gjatë vitit 2022.

Përmes këtij Raporti shprehim vlerësimin për nivelin e bashkëpunimit nga institucionet e Kosovës. Gjithashtu shperrim mirënjohjen dhe falënderimin tona për partnerët që kanë kontribuar në mbështetje të punës sonë për gjatë viteve. Roli i partnerëve, si: Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian dhe bashkëpunimi me Shoqërinë Civile janë garanci të rezultatit në punën tonë në përmbushje të detyrimeve kushtetuese e ligjore.

Në vitin 2023 do të përqendrohemi në mbikëqyrjen e përmbushjes së detyrimit të shtetit në raport me grupet e ndjeshme të personave që mbahen pa vullnetshëm të privuar nga liria, si: persona me çrregullime mendore, personave që vuajnë nga sëmundje të rënda dhe të grupeve të tjera të cënueshme.

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

1 https://www.echr.coe.int/documents/convention_sqi.pdf

2 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922>

KAPITULLI I

I. MEKANIZMI KOMBËTAR PËR PARANDALIM TË TORTURËS

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të torturës (MKP) i Avokatit të Popullit, në bazë në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, realizon vizita të rregullta dhe pa paralajmërim, në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin në qendrat e emigracionit dhe në çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut.³

Mandati i MKP-së është i bazuar në Protokollin Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese. Ky protokoll hyri në fuqi më 22 qershor 2006.⁴ Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, më 18 dhjetor 2002, në seancën e pesëdhjetë e shtatë (57), me Rezolutën A/RES/57/199, miratoi Protokollin Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese. Ky protokoll hyri në fuqi më 22 qershor 2006.⁵ Qëllimi kryesor i protokollit në fjalë është krijimi i një sistemi të vizitave të rregullta, të cilat ndërmerren nga organe të pavarura ndërkombëtare dhe nacionale, në

vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, me qëllim të parandalimit të torturës dhe të trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.⁶

Republika e Kosovës nuk është palë nënshkruese e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese dhe Protokollit Fakultativ të kësaj konvente, meqenëse ende nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me marrëveshjet dhe me instrumentet ndërkombëtare, garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Këto marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Një ndër konventat e përfshira në këtë nen është edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese, e cila u miratua më 10 dhjetor 1984 dhe hyri në fuqi më 26 qershor 1987.⁷

3 Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 17, paragrafi 2.

4 Zyra e Komisionarit të Lartë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, në: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/opcat.aspx>.

5 Zyra e Komisionarit të Lartë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, në: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/opcat.aspx>.

6 Neni 1 i Protokollit Fakultativ i Konventës Kundër Torturës.

7 Zyra e Komisionarit të Lartë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, në: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cat.aspx>.

Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij, në bazë të Ligjit për Avokatin e Popullit, kanë të drejtë qasjeje në informatat për gjendjen shëndetësore të personave të privuar nga liria, përfshirë edhe qasjen në dosjet e tyre mjekësore, me pajtimin e tyre, si dhe në të dhënat personale të këtyre personave.⁸ MKP-ja u themelua zyrtarisht me vendimin e Avokatit të Popullit, më 16 janar 2016.

Metodologjia e vizitave të MKP-së

MKP-ja, bazuar në nenin 17 të Ligjit për Avokatin e Popullit, kryen vizita pa paralajmërim, në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria. Vizitat e MKP-së kryhen duke u mbështetur në metodologjinë e vizitave. Metodologjia qëndron në vëzhgimin, dokumentimin dhe në intervistimin e personave të privuar nga liria, të zyrtarëve korrektues dhe policorë, si dhe të atyre shëndetësorë.

Metodologjia e MKP-së parasheh përgatitjen e vizitës, përcaktimin e llojit të vizitës, si dhe veprimet të cilat zbatohen me të arritur në institucionin të cilin e viziton.

Çdo vizitë e MKP-së përfshin fazat e mëposhtme:

- Bisedën me menaxhmentin e institucionit;
- Monitorimin e të gjitha dhomave ku qëndrojnë personat e privuar nga liria;
- Bisedat individuale dhe grupe me të privuarit nga liria;
- Biseda me personelin e institucionit;
- Shqyrtimi dhe analizimi i dokumenteve relevante;
- Biseda përfundimtare me udhëheqësin e institucionit pas përfundimit të vizitës, e cila fokusohet në shqetësimet më të rëndësishme, të gjetura gjatë vizitës monitoruese në institucionin përkatës. Gjatë takimit përfundimtar, ekipi monitorues përdor gjuhë konstruktive dhe respekton punën e zyrtarëve të institucionit.

MKP-ja realizon këto lloje vizitash:

Vizitat e përgjithshme - në terren bëhen sipas planit të aktiviteteve, ku pas çdo vizite përpilohet raport me rekomandime.

Vizitat ad-hoc - të realizuara nga kërkesat/informatat e familjarëve, të personave të privuar nga liria apo formave të tjera të informatave të siguruara.

Vizitat përcjellëse - që nënkuptojnë përcjelljen e implementimit të rekomandimeve dhe monitorimi i situatës së të drejtave të personave të privuar nga liria.

Vizita tematike - ku i kushtohet vëmendje një teme të caktuar, si p.sh. instalimi i kamerave të sigurisë në dhomat e vëzhgimit në institucionet korrektuese, paraburgimi, trajtimi i pavullnetshëm në institucione të shëndetit mendor, masat disiplinore, mekanizmi i ankesave etj.

Përbërja e MKP-së gjatë vitit 2022

Përbërja e MKP-së është shumëdisiplinore dhe në pajtim me dispozitat e Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, i cili parasheh që në kuadër të MKP-së të ketë personel me profesione të ndryshme, përfshirë juristë, mjekë, psikologë dhe punëtorë socialë me përvojë në këtë fushë. Përbërja e tanishme e MKP-së është si në vijim:

- Zëvendësi i Avokatit të Popullit, përgjegjës për MKP-në.
- Drejtoresha e MKP-së.
- Këshilltari i lartë juridik për parandalim të torturës.
- Këshilltarja juridike për parandalim të torturës.
- Këshilltare-mjeke.
- Këshilltare-psikologe.
- Këshilltare-punëtoresha sociale.

⁸ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 17, paragrafi 4.

Vizitat e realizuara gjatë vitit 2022

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKP-ja ka realizuar gjithsej 62 vizita. Prej tyre 20 janë vizita të përgjithshme, 19 vizita ad-hoc, 21 vizita përcjellëse, 1 vizitë tematike dhe 1 vizitë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, në kuadër të monitorimit të operacioneve të kthimit me forcë nga Zvicra, në kuadër të bashkëpunimit me Komisionin Nacional Zviceran për Parandalim të Torturës.

Raportet me rekomandime të publikuar gjatë periudhës për të cilën po raportohet MKP-ja ka publikuar tetë (8) raporte me rekomandime pas vizitave të realizuara në institucionet e monitoruara. Përmes këtyre raporteve MKP-ja ua ka adresuar autoriteteve kompetente 38 rekomandime me qëllim të avancimit të të drejtave themelore të personave të privuar nga liria.⁹

Autoritetet kompetente zbatuan 8 rekomandime, 5 prej tyre u zbatuan pjesërisht ndërsa 25 janë në pritje për t'u implementuar.

Për sa u përket vizitave, MKP-ja ka publikuar raportet me rekomandime, si në vijim:

Raport me rekomandime për vizitën në:	Data e publikimit
1. Raport Ex-officio nr.95/2022 për instalimin e kamerave të sigurisë në disa qeli të të burgosurave në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan	24 shkurt 2022
2. Qendrën Korrektuese në Dubravë	14 prill 2022
3. Qendrën Edukuese Korrektuese për të Mitur dhe Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan	20 korrik 2022
4. Qendrën e Mbjajtjes për të Huajt - Vranidoll	25 korrik 2022
5. Qendrën e Paraburgimit në Pejë	16 nëntor 2022
6. Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë	18 nëntor 2022
7. Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan	23 nëntor 2022
8. Institutin e Psikiatrisë Forenzike	30 nëntor 2022

Bashkëpunimi me institucionet e vizituara

Gjatë vizitave të MKP-së në institucionet ku mbahen personat e privuar nga liria, në institucionet e kujdesit social dhe në ato të shëndetit mendor, zyrtarët e institucioneve të vizituara i ofruan ekipit të MKP-së bashkëpunim të plotë, përveç Institutit të Psikiatrisë Forenzike (IPFK).

Në Institutin e Psikiatrisë Forenzike, MKP-ja, në vizitën e parë ad-hoc, të realizuar në fillim të vitit 2022, ku në ekip ishin mjeku dhe juristi i MKP-së, lidhur me intervistimin e disa rasteve individuale, nuk hasën në mirëkuptim me personelin e IPFK-së, duke mos iu lejuar qasja pa marrë aprovimin e drejtorit të IPFK-

⁹ Të gjitha raportet e MKP-së gjenden në ueb-faqen e Avokatit të Popullit <https://oik-rks.org/mekanizmi-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-mkpt/raporte-mkpt/>

së, i cili në atë ditë nuk ishte në institucion. Më 26 korrik 2022, ekipi i MKP-së realizoi vizitë të përgjithshme në IPFK, me përbërje: zëvendësi i Avokatit të Popullit, psikologu dhe punëtori social. Ekipi fillimisht u takua me një psikiatër të IPFK-së, i cili e zëvendësonte drejtorin. Ekipi pati qasje në të gjitha hapësirat e institucionit pa asnjë pengesë. Më 28 shtator 2022, në vizitën përcjellëse, ekipi i MKP-së filloi vizitën në Repartin B për t'i intervistuar disa pacientë, përderisa drejtori nuk ishte i pranishëm në institucion. Pasi drejtori i IPFK-së u njoftua nga stafi i tij që ekipi i MKP-së ishte duke zhvilluar intervista, drejtori i IPFK-së, duke mos respektuar ligjin dhe mandatin e MKP-së, pra të drejtën për realizim të vizitave pa paralajmërim në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, e pengoi vizitën duke kërkuar që ekipi i MKP-së urgjentisht të takoheshin në zyrën e tij dhe nuk e lejoi vazhdimin e vizitës. Ai po ashtu e mohoi kërkesën e ekipit për qasjes në dosjen e personit të gjinisë femërore (V. K.).¹⁰

Lidhur me këtë vizitë pa paralajmërim të Avokatit të Popullit në IPFK, Ministria e Shëndetësisë, konkretisht drejtori i IPFK-së, ndër të tjera është përgjigjur, si në vijim: “Në fund duhet theksuar të gjithë akterëve se Ligji Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit ka hyrë në fuqi me datë 26.06.2015 disa muaj pas themelimit të IPFK-së, pra nuk është planifikuar apo shtjelluar çështja e një institucioni kaq të veçantë si IPFK, andaj edhe mendojmë se institucionet dhe praktikat evropiane kanë evoluar andaj edhe ky ligj sa i përket institucionit tonë duhet të ketë një rregullore udhëzim të veçantë.”¹¹

Avokati i Popullit ua rikujton institucioneve nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku theksohet: “Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë

atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.” Në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit theksohet: “Avokati i Popullit vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.” Paragrafi 2.1 i këtij neni thekson qartë se MKP-ja e Avokatit të Popullit është e obliguar “të vizitojë rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policorë, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganorë, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër ku dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.”

Neni 25, paragrafi 2, i Ligjit për Avokatin e Popullit, lidhur me detyrimin e bashkëpunimit dhe pasojat e refuzimit, thekson qartë: “Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.” Ndërsa në paragrafin 3 theksohet: “Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyjë në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore, për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare.”

Gjithashtu vlen të ceket edhe neni 30 i Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, ku përcaktohet: “Avokati i Popullit, nëpërmjet mekanizmave të tij, vëzhgon rregullisht me anë të inspektimeve periodike, respektimin e të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime mendore në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor.”¹² Andaj përgjigjja e drejtorit të IPFK-së ishte në kundërshtim të plotë me dispozitat kushtetuese e ligjore.

10 <https://oik-rks.org/2022/11/30/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-institutin-e-psikiatri-se-forenzike/>

11 Përgjigje e protokolluar me nr.518/2022, datë 29.12.22.

12 Ligji nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11229>

KAPITULLI II

II. POLICIA E KOSOVËS

Keqtrajtimi fizik

Ekipi i MKP-së, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, ka vizituar disa stacione policore, me qëllim të vlerësimit të përgjithshëm të respektimit të të drejtave themelore të të arrestuarve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, me Kodin e Procedurës Penale dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria e tyre.

Gjatë vizitave, në qendrat e mbajtjes në Policinë e Kosovës, MKP-ja nuk ka marrë ankesa nga personat e arrestuar, për keqtrajtimit fizik apo për mosrespektim të të drejtave themelore të garantuara me akte ligjore vendore dhe ndërkombëtare, të cilët ishin në mbajtje në kohën e vizitës.

Po ashtu, MKP-ja, gjatë vizitave në qendrat e paraburgimit dhe ato korrektuese, ka intervistuar një numër të konsiderueshëm të të paraburgosurve, për të kuptuar më shumë lidhur me trajtimin e tyre nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës. Shumica e të paraburgosurve të intervistuar pohuan se janë trajtuar në mënyrë korrekte dhe profesionale nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe se janë respektuar të drejtat e tyre themelore. Mirëpo pati edhe nga ata të cilët pretenduan se nuk janë trajtuar në mënyrë të dinjitetshme gjatë arrestimit nga Policia e Kosovës.

MKP-ja, gjatë këtij viti, rëndësi të veçantë u ka kushtuar të miturve të arrestuar nga Policia e Kosovës. Gjatë vizitave në vendet e privimit nga liria, të menaxhuara nga Policia e Kosovës, MKP-ja nuk ka hasur në të mitur të arrestuar. Mirëpo MKP-ja, për të kuptuar më shumë lidhur me trajtimin e të miturve nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe për respektimin e të drejtave të tyre themelore, që nga momenti i arrestimit, ka vizituar Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan dhe ka intervistuar të paraburgosurit e akomoduar në këtë qendër. Të gjithë të paraburgosurit e mitur të intervistuar kanë pohuar se janë trajtuar në mënyrë korrekte dhe profesionale nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe se janë respektuar të drejtat e tyre themelore.¹³ Po ashtu, të miturit e intervistuar nga ekipi i MKP-së kanë pohuar se nuk janë mbajtur në Ndalim Policor më shumë se 24 orë.

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), gjatë vitit 2022, ka regjistruar 6 raste për hetim kundër Policisë së Kosovës, bazuar në pretendimet e qytetarëve se janë keqtrajtuar fizikisht. Prej këtyre 6 ankesave, 3 prej tyre janë hapur për hetim të mëtejshëm nga IAP-ja, ndërsa 3 ankesa janë shpallur të papranueshme. Lidhur me rastet ndaj zyrtarëve policorë, MKP-ja ka kontaktuar me Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) për të marrë informata për hetimet dhe gjetjet e tyre. Mirëpo MKP-ja, për të tri rastet është njoftuar nga IPK-ja se, pas hetimit, rastet janë referuar për trajtim disiplinor tek Drejtoria për Hetim të Brendshme dhe Verifikim

13 Raport i MKPT-së për vizitën në Qendrën Edukuese - Korrektuese për të Mitur dhe në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan <https://oik-rks.org/2022/07/26/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-edukuese-korrektuese-per-te-mitur-dhe-ne-qendren-korrektuese-per-te-mitur-ne-lipjan/>

të së Kaluarës në Policinë e Kosovës, pasi IPK-ja gjatë hetimit nuk gjeti elemente të veprës penale.

MKP-ja ka kërkuar nga IPK-ja informata lidhur me numrin e zyrtarëve policorë që janë hetuar nga IPK-ja, për veprën penale: “*Keqtrajtim gjatë detyrës zyrtare ose autorizimeve publike*”, gjatë këtij viti, si dhe për sa raste është rekomanduar suspendim për zyrtarët policorë dhe për sa raste janë ngritur kallëzime penale.

MKP-ja është njoftuar nga IPK-ja se gjatë këtij viti ka regjistruar gjithsej shtatë raste lidhur me veprën penale: “*Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike*”, ku në prokuroritë kompetente janë dërguar tri raste me kallëzim penal, një rast me raport të veçantë dhe tri raste janë ende në hetim. Tre zyrtarë policorë janë suspenduar, të cilët dyshohet se kanë kryer veprën penale: “*Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike*”.

Garancitë procedurale kundër keqtrajtimit fizik

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për Policinë dhe instrumentet ndërkombëtare të përfshira në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përcaktojnë garancitë procedurale kundër keqtrajtimit për personat e arrestuar nga Policia e Kosovës.

Legjislacioni në fuqi njih tri të drejta kryesore për personat e arrestuar nga Policia e Kosovës: e drejta e personit për ta njoftuar një të afërm ose palën e tretë; e drejta për një avokat; e drejta për mjek.

Kodi i Procedurës Penale, në nenin 13, përcakton se çdo person i privuar nga liria duhet të njoftohet

menjëherë në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton, për të drejtën për ndihmë juridike sipas dëshirës së tij, për të drejtën për t'i njoftuar anëtarët e familjes apo ndonjë person tjetër për faktin se është arrestuar dhe se këto të drejta aplikohen gjatë gjithë kohës së privimit nga liria. Ndërsa në nenin 168 përcaktohet se personi i arrestuar ka të drejtë ta njoftojë anëtarin e familjes apo personin tjetër, sipas përzgjedhjes së tij, për arrestimin dhe vendin e ndalimit, menjëherë pas arrestimit; njoftimi i familjarit apo i personit tjetër lidhur me arrestimin mund të vonohet më së shumti deri në 24 orë, kur prokurori i shtetit çmon se kjo kushtëzohet me nevoja të jashtëzakonshme për hetim të rastit. Kjo vonesë nuk aplikohet në rastin e personave të mitur.

Në Ligjin për Policinë¹⁴ potencohet e drejta për ta njoftuar familjen apo personin tjetër për arrestimin edhe për personat të cilët janë në “*ndalim të përkohshëm*”, me qëllim të identifikimit ose për shkak të mbrojtjes së tyre dhe mbrojtjes së të tjerëve.

Sipas Kodit të Procedurës Penale, personat e ndaluar nga Policia e Kosovës, në qendrat e ndalimit nuk duhet të kalojnë më shumë se dyzet e tetë orë (48) nga koha e arrestimit, përveç rasteve kur gjyqtari i procedurës paraprake urdhëron ndryshe. Ndërsa sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur, ndalimi i të miturit nuk mund ta kalojë periudhën njëzet e katër orë (24), dhe pas kalimit të kësaj periudhe, i mituri duhet të lirohet, përveç nëse gjyqtari për të mitur cakton paraburgim.¹⁵

Ndërsa, për sa i përket të drejtës për avokat, personi i ndaluar/arrestuar, në bazë të nenin 166 të Kodit të Procedurës Penale, ka të drejtë për ndihmë të menjëhershme të mbrojtësit pas arrestimit të tij, sipas zgjedhjes së tij.¹⁶ Mirëpo kur pësoni i

¹⁴ Ligji për Policinë, neni 20.

¹⁵ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 60, paragrafi 4.

¹⁶ Kodi i Procedurës Penale, neni 166, paragrafi 1.

arrestuar nuk angazhon mbrojtës, atij i sigurohet mbrojtësi me shpenzime publike.¹⁷

Lidhur me këtë të drejtë, MKP-ja vëren se Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (më tej: KPT), në raportin për vizitën në Republikën e Kosovës, i publikuar më 23 shtator 2021¹⁸, shprehu shqetësimin se Ligji për Policinë nuk parasheh në mënyrë eksplicite të drejtën për të pasur një avokat për personat që mbahen në ndalim të përkohshëm policor.

Për këtë çështje KPT-ja ka përsëritur rekomandimin e saj që autoritetet përkatëse të ndërmarrin hapa për të garantuar që e drejta për të pasur një avokat të garantohet nga legjislacioni për të gjithë personat që policia i privon nga liria (pavarësisht statusit të tyre të saktë ligjor), që nga fillimi i privimit të lirisë.¹⁹

Për sa i përket të drejtës për kontroll mjekësor të personave të arrestuar/ndaluar, Kodi i Procedurës Penale, neni 169, përcakton se personi i arrestuar/ndaluar ka të drejtë për kontroll mjekësor, sipas kërkesës se tij, të kontrollohet nga mjeku apo nga dentisti, sipas përzgjedhjes së tij.²⁰ Po ashtu kur personi i arrestuar tregon shenja të sëmundjes mendore, policia menjëherë mund të urdhërojë kontrollimin nga një psikiatër.²¹ Personave të ndaluar nga Policia e Kosovës u ofrohen shërbimet mjekësore nga institucionet publike, siç janë: Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Qendra Klinike Universitare, varësisht nga nevojat për trajtim.

Përpos akteve ligjore të lartcekura, me të cilat garantohen të drejtat e personave të ndaluar nga Policia e Kosovës, duhet cekur se më 1 tetor 2020, Policia e Kosovës miratoi Procedurat Standarde të

Operimit, qëllimi i të cilave është krijimi i dokumentit bazik, përmes të cilit përcaktohen rregullat dhe procedurat e punës policore, të cilat do të jenë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet në fuqi, me qëllim të respektimit të të drejtave të njeriut, të personave që ndalohen dhe që mbahen në qendrat e ndalimit.²² Për periudhën për të cilën po raportohet, MKP-ja, gjatë vizitave në stacionet policore, nuk mori ankesa nga personat e arrestuar dhe të ndaluar, të cilët i ka intervistuar, për mosrespektim të këtyre të drejtave themelore, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, me Kodin e Procedurës Penale dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria e tyre.

Kushtet fizike të stacioneve policore të vizituara

Qendrat e Ndalimi në Policinë e Kosovës, sipas Procedurave Standarde të Operimit, duhet të jenë në përputhshmëri me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (më tej: KEDN) dhe me rekomandimet e KPT-së, duke u bazuar në Konventën Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të Tjera Mizore Jonjerëzore dhe Poshtëruese.²³

Për sa u përket kushteve fizike të stacioneve policore, MKP-ja konstaton se kushtet materiale në përgjithësi janë në gjendje të pranueshme për sa i përket hapësirës, ndriçimit natyral, artificial dhe higjienës, i plotësojnë kushtet e domosdoshme për akomodim të personave të ndaluar.

17 Kodi i Procedurës Penale, neni 166, paragrafi 2.

18 Shih Raportin e publikuar të KPT-së, <https://rm.coe.int/1680a3eb76>

19 Shih Raportin e KPT-së, paragrafi 24, për vizitën në Republikën e Kosovës, <https://rm.coe.int/1680a3ea32V>

20 Kodi i Procedurës Penale, neni 169, paragrafi 1.

21 Kodi i Procedurës Penale, neni 169, paragrafi 4.

22 Policia e Kosovës, Procedurat Standarde të Operimit për Qendrat e Ndalimit, Ref :DDO-04-23 /2020, datë 1.10.2020.

23 Policia e Kosovës, Procedurat Standarde të Operimit për Qendrat e Ndalimit, Ref :DDO-04-23 /2020, datë 1.10.2020.

Megjithatë, për Qendrën Rajonale të Mbjtjes në Prishtinë (ashtu si në vizitat paraprake të realizuara në këtë qendër), MKP-ja konstaton se kushtet e punës të zyrtarëve policorë nuk janë të mira, pasi ndërtesa është shumë e vjetër dhe ka mungesë të dritës natyrale, ndërsa gjatë dimrit është shumë ftoftë dhe ka lagështi. Në këtë qendër edhe kushtet e të ndaluarve nuk janë në harmoni me aktet ligjore dhe as me standardet ndërkombëtare.

Ndërsa Stacioni Policor “JUG” në Prishtinë, i cili ende është në ish-hotelin “Victory”, nuk i plotëson kushtet për të qenë stacion i mirëfilltë policor. Dhomat e intervistimit në këtë stacion nuk ofrojnë konfidencialitet, pasi intervistimi mund të dëgjohet edhe në dhomat e tjera. Kamerat e sigurisë në këtë stacion mbulojnë vetëm hapësirat e jashtme të objektit dhe në hollin e katit përdhese, ndërsa pjesët e tjera nuk mbulojnë me kamera. Personat e arrestuar/ndaluar në këtë stacion mbahen vetëm deri në gjashtë orë, pastaj dërgohen në stacionet e tjera ku ka qendra të ndalimit.

Kurse gjatë vizitës së MKP-së në Stacionin Policor “VERI” në Prishtinë, realizuar më 25 gusht 2022, vërejtë se ky stacion vazhdon punën në kontejnerë me kushte minimale për punë. Gjatë kësaj vizite, MKP-ja u njoftua nga zyrtarët policorë se së shpejti pritet ndërtimi i stacionit të ri policorë në lagjen “Kodra e Trimave” në Prishtinë, ndërsa, deri atëherë Komuna e Prishtinës do t’ua japë në shfrytëzim një objekt që ndodhet në lagjen “Arbëria”, ku së shpejti pritet zhvendosja e stafit.

Më 30 gusht 2022, MKP-ja vizitoi Stacionin Policor në Fushë Kosovë, ku përsëri vërejtë se ky stacion përballet me kushte të rënda infrastrukturore dhe me kushte minimale për punë për zyrtarët policorë.

Ekipi i MKP-së gjatë këtij viti, përpos stacioneve të lartcekura, ka vizituar edhe Stacionin Policor të

Prizrenit, atë të Mitrovicës së Jugut, të Drenasit, të Hanit të Elezit dhe të Gjilanit dhe ka identifikuar se personat në mbajtje nuk furnizohen rregullisht me mjete higjienike. Po ashtu, jo në të gjitha qendrat e mbajtjes u sigurojnë të ndaluarve çarçafë të pastër për shtretër.

Lidhur me këtë të drejtë, MKP-ja vëren se Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, në raportin për vizitën në Republikën e Kosovës, i publikuar në shtator 2021, rekomandon që autoritetet përkatëse t’i vazhdojnë përpjekjet e tyre për t’i përmirësuar kushtet e ndalimit policor, duke rekomanduar në veçanti që të gjithë personat e ndaluar të kenë qasje në sapunë dhe në letër higjienike.²⁴

Më 7 dhjetor 2022, MKP-ja, përmes shkresës zyrtare, ka kontaktuar me Policinë e Kosovës për t’u informuar me implementimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit drejtuar Policisë së Kosovës lidhur me renovimet e qendrave të mbajtjes dhe të stacioneve policore.

Më 9 dhjetor 2022, Policia e Kosovës, me shkresë zyrtare njoftoi Avokatin e Popullit se sipas kontratës së lidhur në vitin 2021, e që ka vazhduar edhe në vitin 2022, për renovimin e qendrave të mbajtjes, ka përfunduar renovimi dhe janë funksionalizuar qendrat e mbajtjes në këto objekte policore: Deçan, Gjakovë, Rahovec, Lipjan, Drenas, Gjilan, Pejë, Mitrovicë e Jugut dhe Mitrovicë e Veriut.

Po ashtu, Policia e Kosovës, përmes kësaj shkrese e njoftoi Avokatin e Popullit se Stacioni Policor “Veriu” në Prishtinë, nga data 8 nëntor 2022 është zhvendosur përkohësisht në objektin e ri në lagjen “Arbëria” në Prishtinë (objekt i marrë për shfrytëzim nga Komuna e Prishtinës), pasi kërkesa për ndërtimin e objektit të ri gjendet në procedura të prokurimit. Ndërsa Nën-Stacioni Gorazhdec, nga viti 2021, ka filluar punën në objektin e ri. Stacionit

24 Shih Raportin e KPT-së për vizitën në Republikën e Kosovës, paragrafi 36, i publikuar në shtator 2021, <https://rm.coe.int/1680a3ea32V>

Policor në Fushë Kosovë i është shtuar një hapësirë ku është vendosur Njësia e Hetimeve. Për Stacionin Policor “Jugu” në Prishtinë është iniciuar projekti për instalimin e ngrohjes qendrore, i cili gjendet në procedura të prokurimit. Ndërsa gjatë vitit 2022 janë realizuar punimet dhe janë rinovuar Qendra e Mbajtjes në Stacionin Policor në Ferizaj, Stacioni Policor Shtërpçë, si dhe punimet janë duke vazhduar në Stacionin Policor në Graçanicë.

Për sa i përket të drejtës për të parashtruar ankesë lidhur me trajtimin e tyre nga Policia e Kosovës, të arrestuarit kanë të drejtë të parashtrorjnë ankesë në stacionin policor ku mbahen, si dhe në Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK). Përveç kësaj, të arrestuarit mund t'i drejtojnë ankesë edhe Avokatit të Popullit. Për t'u ofruar qasje më të lehtë në shërbimet e këtij institucioni dhe për t'ua mundësuar të arrestuarve dhe të ndaluarve parashtrimin e ankesës në mënyrë konfidenciale, Avokati i Popullit ka vendosur kuti të ankesave në ato stacione policore ku ka qendra të mbajtjes.

Gjatë vitit 2022, në qendrat e ndalimit policor, përveç MKP-së, realizuan vizita edhe këshilltarët juridikë të Avokatit të Popullit nga zyrat rajonale, si: Gjilan, Prizren, Gjakovë, Malishevë dhe Rahovec. Gjatë këtyre vizitave janë hapur kutitë e ankesave dhe janë trajtuar ankesat individuale të të ndaluarve nga policia e Kosovës.

Qendrat e mbajtjes dhe stacionet policore të vizituara gjatë vitit 2022

Institucioni i vizituar	Nr. i vizitave
Qendra Rajonale e Mbajtjes në Prishtinë	2
Stacioni Policor “Veri” në Prishtinë	1
Stacioni Policor “Jug” në Prishtinë	1
Stacioni Policor Fushë Kosovë	1
Stacioni Policor në Mitrovicë-Jug	1
Stacioni Policor në Gjilan	1
Stacioni Policor në Prizren	1
Stacioni Policor Drenas	1
Stacioni Policor në Han të Elezit	1
Pika e Kalimit Kufitar Han i Elezit	1
Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit (SPMK), Vija e Gjelbër	1

KAPITULLI III

III. QENDRAT KORREKTUESE DHE TË PARABURGIMIT

Trajtimi

Ekipi i MKP-së, gjatë vizitave në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit në vitin 2022, në përgjithësi nuk ka marrë ankesa për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. Gjatë vizitave në institucionet korrektuese, MKP-ja në përgjithësi ka vërejtur një komunikim të mirë ndërmjet të burgosurve dhe zyrtarëve korrektues.

Mirëpo MKP-ja, gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese në Dubravë (QKD), e realizuar më 21 deri më 23 shkurt 2021, ka marrë vetëm një ankesë me pretendimin për keqtrajtim nga zyrtarët korrektues.

Lidhur me këto pohime, MKP-ja pas vizitës ka biseduar me drejtorin e QKD-së lidhur me çështje, me ç' rast është njoftuar se për këtë gjë është formuar një komision hetues dhe se MKP-së do t'i dërgohet raporti i hetimit të brendshëm.

Drejtori i QKD-së, më 28 shkurt 2022, me shkresë zyrtare e njoftoi MKP-në, si në vijim: *"Lidhur me këtë rast, komisioni nuk ka gjetur ndonjë provë apo dëshmi, përmes së cilës do të mund të vërtetoheshin pretendimet e të burgosurit N.N, për përdorim të forcës ndaj tij nga ana e mbikëqyrësit apo stafit tjetër që ishin në detyrë. Kjo është vërtetuar plotësisht*

*përmes deklaratave të stafit dhe të burgosurve të dhomës, të cilët e mohojnë një gjë të tillë."*²⁵

Institucioni i Avokati të Popullit, përmes linjës pa pagës, më 25 maj 2022 ka marrë ankesën e të dënuarit F. R., nga Qendra Korrektuese në Dubravë, për mostrajtim të duhur nga Njësia Shëndetësore e Burgjeve (NjShB) dhe nga zyrtarët korrektues.

Lidhur me këtë rast, MKP-ja ka vizituar QKD-në, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant dhe ka intervistuar të burgosurin. Nga dokumentacioni mjekësor ka vërejtur se F. R. i janë dhënë të gjitha shërbimet mjekësore nga NjShB-ja në Dubravë. Lidhur me pretendimet për keqtrajtim, MKP-ja u njoftua nga drejtorja e QKD-së se ata ka zhvilluar një hetim të brendshëm dhe ka dalë me konkluzionin se nuk ka pasur tejkalim të forcës nga zyrtarët korrektuese ndaj të dënuarit F. R.

Po ashtu MKP-ja, gjatë vizitave në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit, ka marrë disa pohime nga një numër i konsiderueshëm i të burgosurve se në raste të caktuar ofendohen verbalisht nga oficerët korrektues. Këto pretendime të të burgosurve, MKP-ja i ka adresuar tek autoritetet përgjegjëse.

MKP-ja verën se lidhur me këtë çështje, edhe Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, në raportin për vizitën në Republikën e Kosovës,

25 Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës i Avokati të Popullit, lidhur me vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë <https://oik-rks.org/2022/04/15/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>

i publikuar në shtator 2021, i ka rekomanduar menaxhmentit të Burgut të Dubravës dhe të Burgut të Sigurisë së Lartë, si dhe menaxhmentit të qendrave të paraburgimit në Mitrovicë e në Prishtinë, ta njoftojnë stafin korrektues se të gjitha format e keqtrajtimit, duke përfshirë abuzimin verbal, janë të paligjshme dhe do të ndëshkohen në përputhje me ligjin.²⁶

Avokati i Popullit, bazuar në shkrimet e mediave të shkruara dhe të atyre elektronike, të publikuara më 7 shkurt 2022, është njoftuar se në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan, në disa qeli ku mbahen të burgosurat, të cilat vuajnë nga probleme serioze shëndetësore mendore, autoritetet e qendrës korrektuese instaluan kamera të sigurisë.

Lidhur me këtë çështje, ekipi i MKP-së, më 8 shkurt 2022, ka vizituar qendrën në fjalë për t'u informuar për së afërmi me situatën. Gjatë vizitës, ekipi MKP-së ka vërejtur se në disa qeli janë instaluar kamera të sigurisë, në të cilat vendosen të burgosurat me gjendje të rëndë të shëndetit mendor, të cilat në parim do të duhej të trajtoheshin në institucione adekuate shëndetësore. Në rastin në fjalë, ekipi i MKP-së ka vërejtur se kamerat e sigurisë mbulonin vetëm shtretërit dhe dritaret e qelive, nuk mbulonin tualetet, dushet dhe lavamanin. MKP-ja u njoftua se arsyeja e instalimit të kamerave të sigurisë në këto qeli ishte mbrojtja e të burgosurave, të cilat përbëjnë rrezik për vetëlëndim apo vetëvrasje për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore. Gjatë vizitës, ekipi MKP-së u njoftua se lidhur me këtë çështje janë suspenduar dy zyrtarë të Qendrës Korrektuese për Femra.

Më 9 shkurt 2022, përmes shkrese zyrtare, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka kërkuar nga Ministria e Drejtësisë informata nëse ka pasur

vendim me shkrim për instalimin e kamerave të sigurisë në qeli të të burgosurave dhe cila është baza juridike e një vendimi të tillë.

Më 14 shkurt 2022, përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë e njoftoi Avokatin e Popullit: *“Nuk ka ndonjë vendim nga Drejtoresha e QK në Lipjan dhe SHKK nuk ka ose nuk është në dijeni se ekziston ndonjë vendim apo procedurë e veçantë/akt nënligjor etj., që rregullon këto veprime”*. Më tej në këtë njoftim theksohet se: *“Shërbimi Korrektuese i Kosovës, më 14.02.2022 ka nxjerrë një vendim për lejimin e instalimit të kamerave të sigurisë nëpër institucionet korrektuese për shkaqe të sigurisë dhe rrethana specifike – për rastet me probleme mendore, duke u bazuar në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.”*

Avokati i Popullit, për rastin në fjalë, ka konstatuar se mungon akti normativ konkret me të cilin do të rregullohej vendosja e kamerave të sigurisë në qelinë e të burgosurit dhe i cili do të ofronte garancitë e duhura procedurale nga ndërhyrja arbitrare e autoriteteve.

Andaj, lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit ka publikuar raportin me rekomandim, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me rekomandimin: *“Të miratoi akt nënligjor i cili do të përfshinte të gjitha garancitë procedurale, kundër ndërhyrjes arbitrare në privatësinë e të burgosurve të cilët i nënshtrohen vëzhgimit me kamera të sigurisë në qelitë e tyre, të parapara me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, vendimet e GJEDNJ dhe standardet e KPT-së, të cekura më lartë.”*²⁷

Më 27 tetor 2022, Avokati i Popullit është njoftuar nga Ministria e Drejtësisë se Shërbimi Korrektuese i Kosovës ka formuar grupin punues për hartimin

26 Raporti i Komitetit Evropian për vizitën në Republikën e Kosovës, i publikuar në tetor 2021, paragrafi 67. <https://rm.coe.int/1680a3ea32V>

27 Raport me rekomandime ex officio nr.95/2022 përkitazi me instalimin e kamerave të sigurisë në disa qeli të të burgosurave në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan <https://oik-rks.org/2022/03/16/raport-me-rekomandime-ex-officio-nr-952022-perkitazi-me-instalimin-e-kamerave-te-sigurise-ne-disa-qeli-te-te-burgosurave-ne-qendren-korrektuese-per-femra-ne-lipjan/>

e Rregullores së brendshme për procedurat dhe masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas rekomandimit të Avokatit të Popullit, rregullore e cila është miratuar nga drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Korrektuese të Kosovës.

Incidentet ndërmjet të burgosurve

Gjatë këtij viti janë shënuar disa incidente në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit, kryesisht në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Këto informata Avokati i Popullit i ka siguruar përmes thirrjeve telefonike dhe raporteve të dërguara nga Drejtoria Shëndetësore e Burgjeve. MKP-ja, gjatë vizitave dhe përmes komunikimit zyrtar me autoritetet kompetente, ka vërejtur se këto incidente janë evidentuar në formularë përkatës, në dokumente të tjera administrative, si dhe në protokollet adekuate të njësive shëndetësore.

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në njoftimet zyrtare dhe në dokumentacionin të cilin e ka marrë nga autoritetet, vëren se lidhur me incidentet ndërmjet të burgosurve janë zhvilluar hetime të brendshme dhe hetime nga Policia e Kosovës në raste të caktuara, si dhe në disa raste janë shqiptuar masa disiplinore bazuar në gjetjet e komisioneve disiplinore. Po ashtu, autoritetet e burgjeve kanë ndërmarrë masa për të garantuar sigurinë fizike të të burgosurve në rastet e incidenteve.

Kushtet e akomodimit në qendrat korrektuese dhe në qendra të paraburgimit

Ligji nr.08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), në nenin 35, paragrafi 2, shprehimisht përcakton: “Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta, dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.”²⁸

Po ashtu sipas LESP-së, hapësirat e banimit për të burgosur nuk duhet të kenë lagështi dhe duhet të kenë pajisje sanitare adekuate dhe mjete të tjera të nevojshme për higjienë personale.²⁹

Ndërsa sipas standardeve minimale të KPT-së³⁰, hapësira personale e jetesës për të privuarit nga liria në institucionet e burgjeve, është:

- 6m² hapësirë të jetesës për një qeli me një të burgosur të vetëm me pajisje sanitare;
- 4m² hapësirë jetese për çdo të burgosur në një qeli me shumë të burgosur + anekse plotësisht të ndara sanitare;
- të paktën 2 metra mes mureve të qelisë;
- të paktën 2.5 metra mes dyshemesë dhe tavanit të qelisë.

Gjatë vizitës në **Qendrën Korrektuese në Dubravë**,³¹ MKP-ja ka vërejtur se kushtet e akomodimit në përgjithësi mund të konsiderohen se janë në pajtim me LESP-në dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.

28 Ligji nr.08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867>

29 Ligji nr.08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 35, paragrafi 3, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867>

30 <https://rm.coe.int/16807824b2>

31 <https://oik-rks.org/2022/04/15/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>

Mirëpo, në raste të caktuara, MKP-ja mori disa pohime nga të burgosurit se mungonte uji i ngrohtë si dhe shtypja e ujit gjatë verës është e vogël (pavijonet 1, 3, 4 dhe 5). Sipas tyre, uji i ngrohtë nuk është i mjaftueshëm për pastrim dhe mirëmbajtje të higjienës. MKP-ja vëren se nenin 37 i LESP-së përcakton: *“Me qëllim të sigurimit të higjienës së personave të dënuar dhe higjienës së lokaleve, personave të dënuar të i'u sigurohet sasi e mjaftueshme e ujit të ftohtë dhe të nxehtë si dhe, artikuj adekuat për pastrim dhe tualet. Pajisjet dhe mjetet për higjienë personale sigurojnë privatësinë e mjaftueshme të dënuarit dhe ata mirëmbahen dhe pastrohen me rregull.”*³²

Po ashtu MKP-ja gjatë vizitës sërish ka vërejtur se të burgosurit përdorin pajisje elektrike të improvizuara për ngrohje të ujit, të cilat mund t'i rrezikojnë seriozisht jetët e tyre. Sipas pohimeve të të burgosurve, në mungesë të ujit të ngrohtë, ata detyrohen të përdorin pajisje të tilla të improvizuara. Lidhur me këtë, MKP-ja menjëherë ka shprehur shqetësimin tek zyrtarët kompetentë, të cilët e njoftuan ekipin monitorues se janë duke bërë përpjekje të vazhdueshme që të mos lejohen këto pajisjes.

MKP-ja gjatë monitorimit në këtë qendër po ashtu ka pranuar disa ankesa nga të dënuarit se ka mungesë të dyshekëve dhe të jastëkëve cilësorë (pavijonet 1, 3, 5 dhe Pavijoni Gjysmë i Hapur (PGjH)). MKP-ja aty për aty e ka shprehur shqetësimin te zyrtarët kompetentë.

Lidhur me këto pohime, Avokati i Popullit, në raportin për vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë, i publikuar më 14 prill 2022, i ka rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë: *“Të dënuarit të furnizohen mjaftueshëm me ujë të ngrohtë dhe me dyshek cilësorë.”*³³

Ministria e Drejtësisë, lidhur në rekomandimin e Avokatit të Popullit, është përgjigjur duke potencuar se për këtë çështje janë njoftuar nga QKD-ja se furnizohen rregullisht me ujë të ngrohtë dy herë në javë, ndërsa punëtoritë dhe Pavijoni Gjysmë i Hapur (PGjH) kanë furnizim me ujë të ngrohtë çdo ditë. Ndërsa, për sa u përket furnizimeve me shtrojëmbulojë, gjatë vitit 2021 ka pasur një furnizim të gjerë të institucioneve korrektuese me dyshekë dhe me batanije të reja. Po ashtu, Shërbimi Korrektues i Kosovës planifikon që PGjH-në dhe disa dhoma në ambiente të tjera brenda institucioneve, t'i pajisë me dyshekë të rinj gjatë vitit 2022.

Kurse për kushte e akomodimit në Spitalin e Qendrës Korrektuese në Dubravë, MKP-ja ka vërejtur se objekti në përgjithësi nuk i plotëson kushtet as për të shtrirët në spital dhe as për stafin shëndetësor, pavarësisht rinovimeve që janë bërë. Duhet cekur se spitali i QKD-së ka dy kate dhe posedon vetëm shkallë, kjo paraqet vështirësi për pacientët, e sidomos për personat me aftësi të kufizuar.

Lidhur me këtë çështje Avokati i Popullit, në Raportin me rekomandim për Qendrën Korrektuese në Dubravë i ka rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë: ***“Të krijohen kushte adekuate për të hospitalizuarit në spitalin e burgut.”***³⁴

Ministria e Drejtësisë, lidhur me këtë rekomandim, është përgjigjur, si në vijim: *“Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Departamentin Shëndetësor të Burgjeve (DSHB) në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, më herët janë pajtuar përshtatjen e ambienteve në Pavijonin D për të vendosur të dënuarit me probleme mendore duke përfshirë krijimin e gjitha kushteve në pikëpamje të infrastrukturës dhe personelit adekuat për trajtimin e tyre sipas nevojave specifike dhe standardeve ndërkombëtare në këtë fushë. SHKK me DSHB-në*

32 Ligji nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 37, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867>

33 <https://oik-rks.org/2022/04/15/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>

34 <https://oik-rks.org/2022/04/15/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>

janë në fazën përfundimtare të përgatitjeve për vendosjen e një numri prej rreth 60 të dënuarve në këto hapësira dhe pritet që kjo të realizohet përfundimisht deri në fund të këtij viti, Ndërsa edhe në pavijonin 7 do të krijohen hapësira shtesë për vendosjen e një numri më të madh të të dënuarve me nevoja të veçanta.”

Gjatë vizitës përcjellëse të MKP-së të realizuar më 6 dhjetor 2022, në QKD, ekipi i MKP-së është informuar nga menaxhmenti i kësaj qendre se janë në finalizim të adaptimit të Pavijonit D, ku pritet të vendosen të burgosurit me probleme mendore. Po ashtu, Departamenti Shëndetësor i Burgjeve ka hapur konkurs për rekrutimin e stafit shëndetësor të dedikuar për këtë pavijon.

MKP-ja, gjatë vizitës në **Qendrën Korrektuese për Femra (QKF)**³⁵, të realizuar më 13 tetor 2022, vërejt se qelitë ku akomodohen të burgosurat kanë ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial, si dhe nuk kanë lagështi. Për sa i përket hapësirës për banim për të burgosurat, MKP-ja vërejt se hapësira në dispozicion është në pajtim me dispozitat e LESP-së dhe me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT).³⁶ Po ashtu MKP-ja gjatë vizitës nuk vërejt mbipopullim në QKF dhe shumica e të burgosurave qenë të vendosura vetëm në dhoma, sipas kërkesave të tyre.

MKP-ja, edhe gjatë vizitës në këtë vit, mori përsëri ankesa nga të burgosurat se dushet dhe makineritë në lavanderi, si pasojë e gjendjes teknike, nuk janë funksionale.

Lidhur me këtë, Avokati i Popullit, përmes raportit me rekomandime, publikuar më 23 nëntor 2022³⁷, ka ripërsëritur rekomandimet drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, që të bëhen rregullimet teknike të dusheve dhe të makinerive në lavanderi.

MKP-ja gjatë këtij viti i kushtojë rendësi të veçantë funksionimit të **Shtëpisë së Nenave në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan**.³⁸ MKP-ja ka realizuar vizitë më 7 korrik 2022, ka intervistuar të burgosurën M. I., e cila ishte e vendosur së bashku me fëmijën e saj tetëmuajshe dhe është evidentuar se Shtëpia e Nenave nuk i plotëson kushtet elementare për akomodim në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe as me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurave me fëmijë.

Lidhur me këtë çështje, MKP-ja, më 15 korrik 2022, i është drejtuar me shkresë zyrtare drejtorit të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe në po të njëjtën ditë është njoftuar se Shërbimit Korrektues i është ndarë buxhet për ndërtimin e Shtëpisë së re të Nënës me Fëmijë, për vitin 2023. Mirëpo, deri në realizimin e këtij projekti, sipas drejtorit, ShKK-ja me urgjencë do t'i ndërmarë veprimet e nevojshme për funksionalizimin dhe rinovimin e Shtëpisë së Nenave. Renovimet e kryera, MKP-ja i ka vërejtur gjatë vizitës se realizuar në tetor të këtij viti.

Lidhur me këtë, MKP-ja, përmes raportit me rekomandime, i publikuar më 23 nëntor 2022³⁹, i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që Shtëpia e Nenave të pajisjet me inventar të ri, përderisa kjo shtëpi është në përdorim.

35 <https://oik-rks.org/2022/11/25/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-per-femra-ne-lipjan/>

36 Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449/>

37 <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2022/11/Raport-i-AP-MKPT-lidhur-me-viziten-ne-Qendren-Korrektuese-per-Femra-ne-Lipjan-1-1.pdf>

38 <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2022/11/Raport-i-AP-MKPT-lidhur-me-viziten-ne-Qendren-Korrektuese-per-Femra-ne-Lipjan-1-1.pdf>

39 <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2022/11/Raport-i-AP-MKPT-lidhur-me-viziten-ne-Qendren-Korrektuese-per-Femra-ne-Lipjan-1-1.pdf>

Në raportin për vizitën në **Qendrën e Paraburgimit në Pejë**⁴⁰ (QPP), MKP-ja edhe gjatë këtij viti ka konstatuar se për sa u përket kushteve të akomodimit në këtë qendër, në kuptim të ndriçimit dhe të ventilimit, nuk janë në pajtim me LESP-në⁴¹ dhe as me standardet e përcaktuar nga KPT-ja.

MKP-ja, gjatë vizitës së realizuar në këtë qendër më 7 korrik 2022, ka marrë ankesa të shumta nga të paraburgosurit dhe nga të dënuarit, lidhur me kushtet e akomodimit në QPP. Të burgosurit e intervistuar pohuan se në dhomat ku janë të akomoduar ka shumë lagështi. Për t'i vërtetuar pohimet e tyre, MKP-ja ka vizituar dhomat në krahun B në QPP dhe ka vërejtur se pohimet e tyre qëndrojnë. Ekipi i MKP-së po ashtu ka pranuar ankesa të shumta nga të burgosurit për mungesën e hapësirës në QPP dhe për ndriçimin natyral dhe artificial.

MKP-ja edhe përmes këtij raporti ka ripërsëritur rekomandimin që kushtet e akomodimit në QPP, përderisa kjo qendër është në përdorim, të jenë në pajtim me standardet e përcaktuara në LESP; me standardet e KPT-së dhe me standardet e tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.⁴²

Gjatë vizitës në **Burgun e Sigurisë se Lartë**, realizuar më 8 gusht 2022, MKP-ja ka theksuar se në përgjithësi kushtet e akomodimit janë në nivel të kënaqshëm në shumicën e pavijoneve dhe të hapësirave të tjera, në kuptim të hapësirës, pastërtisë, si dhe qasjes në dritë natyrale dhe artificiale.

Për sa u përket kushteve të akomodimit në **Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë**, MKP-ja ka vërejtur se qelitë ku akomodohen të burgosurit kanë dritë

të mjaftueshme natyrore, hapësirë banimi, e cila shkon përtej standardit të përcaktuar me LESP dhe me standardet e përcaktuara nga KPT-ja. Po ashtu, MKP-ja vërejtë se ka qeli adekuate në dispozicion të të burgosurve me aftësi të kufizuara.

Lidhur me **Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë** dhe me **Qendrën e Paraburgimit në Prizren**, MKP-ja vërejtë se kushtet e akomodimit në përgjithësi ishin të pranueshme, përveç në raste të caktuara, në kuptim të hapësirës për banim për një të burgosur, ku kushtet e akomodimit nuk janë në pajtim me LESP-në, me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve dhe as me standardet e KPT-së.

Ndërsa gjatë vizitës në **Qendrën e Paraburgimit në Gjiilan**, MKP-ja përsëri ka vërejtur se qelitë ku akomodohen të burgosurit janë në pajtim me LESP-në dhe me standardet e KPT-së, kanë ndriçim të mjaftueshëm, nuk kanë lagështi dhe po ashtu kanë ngrohje adekuate dhe pastërti.

Në raportin për **Qendrën Edukuese për të Mitur në Lipjan**, MKP-ja ka vërejtur se kushtet ku mbaheshin të miturit e gjinisë mashkullore në QEKM ishin shumë të mira, dhomat ishin të pastra dhe të ndriçuara, shtretërit e të miturve kishin çarçafë, batanije, përveç dyshekëve të cilët ishin të vjetruar dhe jociësorë. Dhomat ku qëndronin të miturit ishin të mëdha dhe kishin ndriçim të mjaftueshëm, posedonin TV, dollapë personale. Secila dhomë kishte tualete të cilat ishin në gjendje të rregullt, të përshtatshme dhe kishin ujë të ngrohtë pandërprerë. Po ashtu, dhomat dhe tualetet, të cilat ishin të dedikuara për personat me nevoja të veçanta, i plotësonin kushtet për këtë kategori.

40 <https://oik-rks.org/2022/11/17/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-peje/>

41 Ligjit nr.08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 35, paragrafi 3, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867>

42 Raporti i MKP-së për Qendrën e Paraburgimit në Pejë <https://oik-rks.org/2022/11/17/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-peje/>

MKP-ja konsideron se QEKM-ja i plotëson të gjitha kushtet për akomodim të të miturve.⁴³

Lidhur më këtë, përmes raportit me rekomandime për vizitën në këtë qendër, MKP-ja I rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë, që të miturit në Qendrën Edukuese në Lipjan të furnizohen me dyshekë cilësorë.

MKP-ja në afat ligjor u njoftua nga Ministria e Drejtësisë se Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) ka njoftuar se në stoqet e Qendrës Edukuese Korrektuese (QEK) aktualisht ndodhen vetëm 4 dyshekë të papërdorur (te pavijoni B, i cili planifikohet të rinovohet në të ardhmen). ShKK-ja është siguruar se të njëjtët do shpërndahen menjëherë për nevoja të Qendrës Edukuese Korrektuese. Po ashtu, stafi i QEK-ut është duke vlerësuar nevojat dhe gjendjen për dyshekë, për të parë mundësinë që një pjesë e tyre që nuk është dëmtuar, të mundë të përdoren edhe për një kohë. Po ashtu ShKK-ja planifikon që deri në fund të vitit 2022 të ketë një furnizim të gjerë të institucioneve korrektuese, duke përfshirë edhe QEK-un për të Mitur në Lipjan.

Po ashtu gjatë kësaj vizite, MKP-ja verën se kushtet e akomodimit në Njësinë B, pjesë e paraparë për të femrat e mitura, kushtet e akomodimit janë shumë të mira. Dhomat ofronin ndriçim të mjaftueshëm, secila dhomë kishte tualet, që ishte në gjendje shumë të mirë. MKP-ja ka vërejtur se neni 30, paragrafi 1, i Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKM-së thekson: “*Të miturat gëzojnë të gjitha të drejtat që u garantohen të miturve meshkuj në Qendrën Edukuese-Korrektuese.*” Po ashtu në nenin

30, paragrafi 3, përcakton: “*Të miturat vendosen në pavijon të veçantë të QEKM, të veçuara nga të miturit meshkuj dhe mbahen në mbikëqyrjen dhe kujdesin e stafit femëror.*”

Po ashtu, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) thekson se femrat e mitura, në asnjë rrethanë, nuk duhet të marrin më pak kujdes, mbrojtje, ndihmë dhe trajtim sesa meshkujt e mitur, pavarësisht faktit se numri i tyre është shumë më i vogël dhe se qendrat e dënimit pothuajse gjithnjë konceptohen për të dënuar meshkuj. Nëse është e nevojshme, duhen marrë masa shtesë për të siguruar trajtimin e barabartë.⁴⁴

Ndërsa për sa u përket kushteve të akomodimit në **Qendrën Korrektuese për të Mitur**⁴⁵, MKP-ja ka vërejtur se në dhoma kishte dritë të mjaftueshme natyrale dhe artificiale. Në përgjithësi MKP-ja konsideron se Qendra Korrektuese për të Mitur plotëson kushtet adekuate për akomodimin e të miturve të burgosur.

Regjimi për të dënuarit

Shërbimi Korrektues i Kosovës, në bashkëpunim me të gjithë partnerët dhe në përshtatshmëri të vazhdueshme me ligjet e aplikueshme në Kosovë, synon t'i korrektojë dhe risocializojë të dënuarit, duke respektuar të drejtat fundamentale pa marrë parasysh racën, gjuhën, religjionin si dhe të sigurojë ambient të sigurt për stafin, të dënuarit dhe shoqërinë.⁴⁶

43 Raporti i MKP-së për vizitën në Qendrën Edukuese për të Mitur dhe në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan, i datës 20 korrik 2022. <https://oik-rks.org/2022/07/26/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-edukuese-korrektuese-per-te-mitur-dhe-ne-qendren-korrektuese-per-te-mitur-ne-lipjan/>

44 CPTInf-2015-1-part-alb.docx.pdf

45 Raporti i MKP-së për vizitën në Qendrën Edukuese për të Mitur dhe në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan, i datës 20 korrik 2022. <https://oik-rks.org/2022/07/26/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-edukuese-korrektuese-per-te-mitur-dhe-ne-qendren-korrektuese-per-te-mitur-ne-lipjan/> CPTInf-2015-1-part-alb.docx.pdf

46 Rregullorja e brendshme për tretmanë, neni 2, Misioni i Shërbimit Korrektues të Kosovës. <https://shkk.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Rregullorja%20e%20brendhsme%20per%20tretman.pdf>

Po ashtu, LESP-ja dhe Kodi i Procedurës Penale⁴⁷, si dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve, shprehimisht përcaktojnë obligimin e autoriteteve kompetente që të burgosurit t'i angazhojnë në punë, në aktivitete kulturore, arsimore dhe sportive, që do të ndikonin në risocializimin e tyre.⁴⁸

Sipas rregullores së brendshme për tretmanë të Shërbimit Korrektuese të Kosovës, më qellim të socializmit dhe rehabilitimit të të dënuarve parashihet implementimi i katër llojeve të tretmanëve: tretmanin e pranimit, tretmanin themelore, standard dhe i avancuar.⁴⁹

MKP-ja gjatë vizitës në **Qendrën Korrektuese në Dubravës** ka vërejtur se funksionojnë tri punëtori, të cilat në fakt janë edhe qendra për trajnime profesionale, ku organizohen trajnime për saldim, për ndërtimtari, për axhustator, për zdrukthëtari, për mirëmbajtje teknike, për instalim të ujit dhe për instalim të rrymës. Në këto punëtori organizohen kurse me kohëzgjatje prej tre muajsh. Po ashtu, MKP-ja ka vërejtur se janë rreth 260-300 të burgosur të angazhuar në punë në këtë qendër. Të dënuarit mund të lëvizin të lirë brenda pavijoneve ku ishin të vendosur dhe kanë të drejtë në 3 orë shëtitje në ditë gjatë stinës së verës, kurse gjatë dimrit deri në 2 orë në ditë.

Po ashtu, në kuadër të Qendrës Korrektuese në Dubravë funksionon edhe shkolla e mesme, në të cilën mësimin e vijnë 37 nxënës. Shkolla është paralele e ndarë e Shkollës së Mesme Teknike "Mithat Frasheri" në Gurrakoc - Istog, drejtimi për makineri. Mirëpo ekipi i MKP-së gjatë vizitës, nga intervistimi i të dënuarve është informuar se disa të

dënuar nuk dinë shkrim-lexim. Një fakt të tillë e ka pohuar edhe udhëheqësi për programe dhe arsim.

Lidhur me këtë, neni 83, paragrafi 1, i LESP-së përcakton "*Personi i dënuar ka të drejtë në shkollim fillor dhe të mesëm në pajtim me ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm.*" Gjithashtu në ligj theksohet se përgjegjës për arsimimin fillor dhe të mesëm në institucionin korrektues është ministria kompetente për arsim. Neni 83, paragrafi 4, përcakton: "*Për personat e dënuar që nuk din shkrim lexim të organizohen kurse të posaçme.*"

Lidhur me këtë MKP-ja, në raportin për Qendrën Korrektuese në Dubravë, i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë: "*Të organizohen kurse të veçanta për të burgosurit që nuk dinë shkrim-lexim.*"⁵⁰

Ndërsa për regjimin në **Burgun e Sigurisë së Lartë**, gjatë vizitave të realizuara në vitin 2022, MKP-ja përsëri vërejtë se shumica e të burgosurve janë të angazhuar në punë të ndryshme, siç është mirëmbajtja, pastrimi i pavijoneve, puna në kuzhinë, në punëtorinë për prodhim të letrës higjienike dhe të qeseve, nga ku furnizohen edhe institucionet e tjera të ShKK-së. Po ashtu, të dënuarit mund të lëvizin të lirë brenda pavijoneve ku ishin të vendosur, përveç në rastin e të paraburgosurve. Të burgosurit kanë të drejtë për 3 orë shëtitje në ditë gjatë stinës së verës, kurse gjatë dimrit deri në 2 orë në ditë.

Për sa i përket regjimit të të burgosurve në **Qendrën Korrektuese për Femra**, MKP-ja, gjatë vizitës të realizuar më 13 tetor 2022, u njoftua nga të dënuarat se shumica prej tyre janë të angazhuara në punë në furrë, në kuzhinë, në rrobaqepësi dhe në pastrim, ndërsa gjatë stinës së verës angazhohen

47 Kodi i Procedurës Penale, neni 199, paragrafi 2, dhe neni 200.

48 Ligji për Ekzekutimin e Sankcioneve Penale, neni 55, si dhe neni 200, paragrafi 1.

49 Rregullorja e brendshme për tretmanë, neni 10, Llojet e Tretmanëve. <https://shkk.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Rregullorja%20e%20brendshme%20per%20tretman.pdf>

50 Raport i MKP-së për vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë, <https://oik-rks.org/2022/04/15/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>

në kopshte dhe në serrën e qendrës. Kurse të paraburgosurat janë shumë pak të angazhuara në punë dhe në aktivitete të tjera, pasi angazhimi i tyre është subjekt i lejes së gjykatës kompetente.

Ekipi i MKP-së u njoftua se tani është duke u mbajtur trajnimi për prodhimin e bizhuterive të filigranit, trajnim i mbështetur nga "HELP Kosova". Në këtë trajnim janë të angazhuara pesë të dënuara. Trajnimi zgjat një vit mbahet nga instruktorë të specializuar të këtij programi. Të dënuarat, në fund të trajnimit pajisen me certifikatë. Po ashtu MKP-ja u njoftua nga të dënuarat se atyre u mundësohet shëtitja jashtë qelisë dy herë në ditë, nga një orë, gjë që është në pajtim me nenin 36 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Mirëpo MKP-ja përsëri mori ankesa nga të dënuarat, sidomos nga ato me burgim afatgjatë, të cilat pohuan se numri i aktiviteteve dhe i angazhimeve në QKF nuk është i mjaftueshëm. Avokati i Popullit i ka potencuar ankesat e njëjta edhe në Raportin me rekomandime për Qendrën Korrektuese për Femra dhe për Qendrën Korrektuese për të Mitur⁵¹, i cili ishte publikuar më 23 dhjetor 2021, ku ishte rekomanduar: "Të shtohen aktivitetet jashtë qelisë për të burgosurat (përfshirë të paraburgosurat), kur një gjë e tillë është e mundur. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet të burgosurve të dënuar me dënime afatgjata." Andaj MKP-ja edhe në raportin e publikuar më 25 nëntor 2022, ka ripërsëritur këtë rekomandim për Ministrinë e Drejtësisë⁵².

Për sa i përket regjimit për të mitur të privuar lirie, MKP-ja ka vërejtur se atyre, përveç ajrimit ditor, u ofrohet një regjim gjithëpërfshirës duke përfshirë shkollim, trajnime për fusha të ndryshme, punë,

si dhe aktivitete sportive dhe rekreative. MKP-ja regjimin e të miturve e ka përshkruar në Raportin me rekomandime për të miturit në Qendrën Korrektuese për të Mitur dhe në Qendrën Edukuese për të Mitur në Lipjan.⁵³

Regjimi për të paraburgosurit

MKP-ja edhe gjatë vizitave të këtij viti vëren një regjim të varfër për të paraburgosurit. MKP-ja përsëri konstaton se ka vërejtur se shumica e të paraburgosurve, pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve të qendrave të paraburgimit, shumicën e kohës e kalojnë të mbyllur në qelitë e tyre, për shkak të infrastrukturës (Qendra e Paraburgimit në Prizren dhe ajo në Pejë dhe pjesërisht ajo në Mitrovicë) dhe për shkak se angazhimi i tyre në aktivitetet jashtë qelisë është subjekt i lejes së gjykatës kompetente.

MKP-ja vëren se neni 199, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale përcakton angazhimin e të paraburgosurit në punë dhe në aktivitete të tjera jashtë qelisë, si në vijim: "I paraburgosuri mund të kryejë punë të nevojshme për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në ambientin e tyre. Të paraburgosurit mund t'i lejohej të punojë në aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos e dëmtojë procedurën penale. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos për këtë në marrëveshje me drejtorinë e institucionit." Ndërsa neni 200, paragrafi 1, i LESP-së, lidhur me angazhimin e të paraburgosurit në punë, përcakton si në vijim: "I paraburgosuri mund të angazhohet me punë në punëtori, punëtoritë e njësive ekonomike të

51 Shih Raportin e publikuar më 23 dhjetor 2021: <https://oik-rks.org/2021/12/24/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-per-femra-dhe-qendren-korrektuese-per-te-mitur-ne-lipjan/>.

52 Raporti i MKP-së për Qendrën Korrektuese për Femra <https://oik-rks.org/2022/11/25/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-per-femra-ne-lipjan/>.

53 Raport i MKPT-së për vizitën në Qendrën Edukuese Korrektuese për të Mitur dhe në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan <https://oik-rks.org/2022/07/26/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-edukuese-korrektuese-per-te-mitur-dhe-ne-qendren-korrektuese-per-te-mitur-ne-lipjan/b>

cilat gjenden në rrethin e institucionit korrektues përkatës pas marrjes së pëlqimit të gjykatës kompetente.”

Lidhur me regjimin e të burgosurve, MKP-ja vëren se Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, në raportin e fundit për vizitën në Republikën e Kosovës, i publikuar në tetor 2021, përsërit rekomandimin për autoritetet përkatëse që të gjithë të burgosurve t'u sigurohet një regjim gjithëpërfshirës i aktiviteteve jashtë qelisë. Më qellim të sigurimit që të gjithë të burgosurit (përfshirë ata në paraburgim) të jenë në gjendje të kalojnë një pjesë të ditës jashtë qelive të tyre, të përfshihen në aktivitete të një natyre të ndryshme: punë, mundësisht me vlerë profesionale, arsim, sport, rekreacion/shoqërim.⁵⁴

Kontaktet me botën e jashtme

Sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, personat e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar për korrespondencë (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për vizita familjare, e cila zgjat minimum një orë, si dhe për vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Përveç kësaj, ata kanë të drejtë për të bërë telefonata, si dhe për të burgosurit të cilët i kanë familjarët jashtë shtetit u mundësohet komunikimi përmes platformës Skype.

Ndërsa për të paraburgosurit, neni 200 i Kodit të Procedurës Penale i Kosovës përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita *“brenda kufijve të rregullave të qendrës së paraburgimit”*, bazuar në lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij. Më tej Kodi përcakton

se korrespondenca dhe vizitat e tjera i nënshtrohen vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake.

Për sa u përket shtetasve të huaj të burgosur, atyre u ofrohet mundësia që me shkrim ose me gojë të kontaktojnë me përfaqësinë diplomatike apo me zyrën përkatëse të shtetit, shtetësinë e të cilit e ka ai/ajo.⁵⁵

Po ashtu, i dënuari dhe i paraburgosuri ka të drejtë të korrespondojë me avokatin mbrojtës të tij/saj, i cili e përfaqëson në procedurë ligjore. Personi i dënuar ka të drejtë në komunikim konfidencial me përfaqësuesin e tij/saj, pa praninë e personelit korrektues.⁵⁶

Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund t'i vizitojnë të dënuarit dhe të paraburgosurit dhe të korrespondojnë me ta, pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrje. Letrat e të paraburgosurit dhe të të dënuarit, të cilat i dërgohen Institucionit të Avokatit të Popullit, nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të dënuarin dhe me të paraburgosurin.

Për periudhën për të cilën po raportohet, MKP-ja, gjatë vizitave në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit, nuk ka marrë asnjë ankesë nga të paraburgosurit dhe as nga të dënuarit lidhur me të drejtën për të kontaktuar me botën e jashtme.

54 Raporti i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, në raportin për vizitën në Republikën e Kosovës, <https://rm.coe.int/1680a3ea32>

55 Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 63, paragrafët 1 dhe 2. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867>

56 Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 62, paragrafët 1 dhe 2. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867>

Procedura e parashtrimit të ankesave në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit

Sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, personi i dënuar ka të drejtë ankimi në procedurën dhe në vendimin ndaj të punësuarve në institucionet korrektuese. Ankimi paraqitet gojarisht, apo me shkrim nëpërmes drejtorit të institucionit korrektues, Zyrës Qendrore të Shërbimit Korrektues. Ankesa me shkrim, drejtuar Zyrës Qendrore, i dërgohet në mbështjellës të cilin drejtorja e institucionit korrektues nuk guxon ta hap.⁵⁷

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKP-ja ka marrë disa ankesa nga të burgosurit për mospërgjigje nga organet kompetente të ShKK-së në ankesat dhe në kërkesat e tyre. MKP-ja këto ankesa/kërkesa i ka proceduar tutje duke kontaktuar me Shërbimin Korrektues të Kosovës, nga i cili është informuar se të gjithë të dënuarit janë njoftuar me përgjigje në formë të shkruar.

Kujdesi shëndetësor në qendrat korrektuese dhe në qendra të paraburgimit

Sipas neni 42, paragrafi 1, të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, personi i dënuar duhet të gëzojë të njëjtat standarde të kujdesit shëndetësor të cilat janë në dispozicion në komunitet.

Hapësirat në të cilat ofrohen shërbimet mjekësore në qendra korrektuese dhe në të paraburgimit, në përgjithësi janë në nivel të kënaqshëm, përpos në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, në Prizren dhe në Mitrovicë. MKP-ja vëren se hapësirat ku ofrohen shërbimet mjekësore në këto qendra nuk janë adekuate dhe nuk mbrojnë konfidencialitetin e shërbimeve mjekësore. MKP-ja edhe gjatë këtij viti vëren se hapësirat për shërbime mjekësore në këto qendra mbesin të njëjta pavarësisht rekomandimeve të MKP-së.

Po ashtu sipas LESP-së, personi i dënuar të cilit nuk mund t'i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrektues, dërgohet në spitalin e institucionit korrektues, në institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjetër për përkujdesje shëndetësore.⁵⁸

Kontrollet mjekësore për të sapopranuarit

Praktika Standarde e Veprimit⁵⁹ e DShB-së dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale⁶⁰ përcaktojnë obligimin që i burgosuri i sapopranuar t'i nënshtrohet kontrollimit mjekësor brenda 24 orësh nga momenti i pranimit. Obligime të tilla përcaktohen edhe me aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve, siç janë: Rregullat e Mandelës⁶¹, Rregullat Evropiane të Burgjeve etj.⁶² MKP-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, bazuar në vizitat e realizuara dhe në raportet e dërguara nga DShB-ja, ka vërejtur se të gjithë të burgosurve të sapopranuar u bëhen kontrollet mjekësore brenda 24 orësh nga momenti

57 Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 90, paragrafi 2. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867>

58 Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 22, paragrafi 6. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867>

59 Praktika Standarde e Veprimit, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>

60 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867bn>

61 Rregullat e Mandelës, Rregulli 34. Shih në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf

62 Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 42.1. Shih në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>.

i pranimit. Lidhur me këtë, MKP-ja gjatë këtij viti nuk ka marrë ankesa nga të dënuarit dhe as nga të paraburgosurit e pranuar.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

Edhe gjatë kësaj periudhe për të cilën po raportohet, MKP-ja, bazuar në intervistat e zhvilluara me të burgosurit dhe me personelin shëndetësor, ka vërejtur se në përgjithësi këto shërbime jepen nën kushte të cilat respektojnë konfidencialitetin, respektivisht jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues, përveç në rastet kur prania e tyre kërkohet nga mjeku. Ndërsa në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor.

Ankesat lidhur me trajtimin mjekësor

MKP-ja gjatë këtij viti ka pranuar ankesa nga të burgosurit për sa i përket trajtimit mjekësor në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit, qoftë gjatë vizitave në terren, nga telefonatat e pranuar, nga familjarët, nga punëtori social, kutitë e ankesave etj. Disa nga këto ankesa janë regjistruar për hetim të mëtejshëm në bazën e të dhënave (databazë) të Avokatit të Popullit dhe do të vazhdojnë të trajtohen edhe në vazhdim. Për të gjitha këto raste, MKP-ja i ka siguruar informatat nga shikimi i dosjeve në terren si dhe informatave shtesë të siguruar nga DShB-ja. Drejtoria Shëndetësore e Burgjeve vazhdimisht e ka njoftuar MKP-në për raporte shëndetësore të personave të privuar lirie me lëndime të pranuar ose të marra gjatë vuajtjes së dënimit, duke përcjellë 63 raporte shëndetësore tek Avokati i Popullit, kjo bazuar në Procedurat Standarde të Operimit të DShB-së.

Prezenca e të burgosurve me probleme mendore në qendrat korrektuese dhe në qendra të paraburgimit

MKP-ja edhe gjatë vizitave të këtij viti në qendrat e paraburgimit dhe ato korrektuese vëren se mbetet sfida prezencja e personave me probleme mendore, për shkak të mungesës së kapaciteteve për t'i akomoduar të burgosurit e kësaj kategorie në institucione përkatëse shëndetësore. MKP-ja ka vërejtur se edhe përgjatë këtij viti, personat me sëmundje mendore, për shkak të pamundësisë për t'i akomoduar në institucione përkatëse, sipas rekomandimit të mjekut kompetent, të burgosurit me probleme serioze mendore vazhdojnë të mbahen në qendra të paraburgimit dhe në ato korrektuese.

MKP-ja vëren se sipas nenit 43 të Ligjit nr. 05/l-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcaktohet: *“Personi i dënuar të cilit nuk mund t'i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrektues dërgohet në spitalin e institucionit korrektues, në institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjetër për përkujdesje shëndetësore.”*

Lidhur me këtë çështje, MKP -ja është njoftuar nga Ministria e Drejtësisë se është duke u bërë planifikimi i hapjes së Pavijonit D në Qendrën Korrektuese në Dubravë për pranimin dhe trajtimin e personave me nevoja të veçanta, projekt i cili është në fazën finale. Stafi korrektues është rekrutuar dhe është nënshtruar trajnimit bazik në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe pritet të fillohet me zbatimin e projektit të Këshillit të Evropës, në të cilën do të përfshihet edhe stafi i Institutit të Psikiatrisë Forenzike.

MKP-ja do të vazhdojë me vizita të rregullta gjatë vitit 2023 ku do të përcjellë për së afërmi veprimet e autoriteteve dhe implementimin e

rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me trajtimin e personave me probleme mendore.

Personeli i qendrave korrektuese dhe i qendrave të paraburgimit

MKP-ja edhe gjatë këtij viti ka pranuar ankesa të shumta nga personeli korrektues, lidhur me kushtet e punës si dhe me numrin e vogël të zyrtarëve korrektues në raport me të burgosurit. Një nga ankesat e shumta është edhe mosfurnizimi me uniforma dhe pajisje të tjera të domosdoshme për ta kryer punën e tyre.

Lidhur me këto shqetësime të zyrtarëve korrektues, MKP-ja, më 11 mars 2022, me shkresë zyrtare i është drejtuar Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Më 21 mars 2022, Shërbimi Korrektues i Kosovës e njoftoi MKP-në se si autoritet kontraktues, Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) më 8.3.2021 ka tenderuar në procedurë të hapur në vlerë të mesme aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me uniforma për stafin korrektues”, mirëpo, pasi komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave, ka ardhur në përfundim se operatorët ekomomikë kanë dorëzuar oferta të papërgjegjshme në aspektin teknik duke anuluar tenderin. Lidhur me këtë operatori ekonomik ka bërë ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Meqenëse OSHP-ja nuk ka pasur bord, nuk ka pasur mundësi të vazhdohet me këtë proces të prokurimit. Situata do të përcillet nga MKP-ja edhe gjatë vitit 2023.

Ndërsa për rritjen e stafit korrektues, MKP-ja u njoftua nga ShKK-ja se ky institucion është në procedurë të rekrutimit të 30 zyrtarëve të rinj për Qendrën Korrektuese në Dubravë dhe se procedura tani është në fazën e ankesave.

Gjatë vizitës përcjellëse në Qendrën Korrektuese në Dubravë, MKP-ja u njoftua se 30 zyrtarë të rinj korrektues kanë filluar punën në këtë qendër. Mirëpo, për sa i përket uniformës, stafi korrektues ende nuk është furnizuar me uniforma të reja. Gjithashtu, stafi i ri korrektues është pranuar edhe në Burgun e Sigurisë së Lart dhe në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë.

Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë për rritjen e numrit të punëtorëve socialë dhe zyrtarëve ligjorë sipas vlerësimit dhe nevojës, situatë që vazhdon të mbetet e njëjtë.

Vizitat e realizuara të MKP-së në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit**Qendrat korrektuese dhe të paraburgimit të vizituara gjatë vitit 2022**

Institucioni i vizituar	Nr. i vizitave
1. Qendra Korrektuese në Dubravë	3
2. Qendra Korrektuese në Smrekonicë	2
3. Qendra Korrektuese për Femra-Lipjan	4
4. Qendra Korrektuese për të Mitur-Lipjan	3
5. Qendra Edukuese Korrektuese për të Mitur në Lipjan	1
6. Qendra e Paraburgimit në Pejë	2
7. Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë	1
8. Qendra e Paraburgimit në Gjilan	1
9. Qendra e Paraburgimit në Prishtinë	4
10. Qendra e Paraburgimit në Prizren	1
11. Burgu i Sigurisë së Lartë	3

KAPITULLI IV

IV. QENDRAT PËR AZILKËRKUES

Ekipi i MKP-së, në bashkëpunim me përfaqësuesit e Komisarariatit të Lartë për Refugjatë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe me përfaqësues të Civil Rights Program Kosova (CRPK), ka realizuar dy vizita në Qendrën e Azilkërkuesve në Magure dhe në Vranidoll. Këto vizita të përbashkëta u realizuan bazuar në Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet organizatave të lartpërmendura me Institucionin e Avokatit të Popullit. Më 30 nëntor 2022, MKP-ja realizoi edhe një vizitë në Qendrën për Azilkërkues në Magure, së bashku me delegacionin nga Avokati i Popullit i Maqedonisë së Veriut.

Vizitat kishin për qëllim vlerësimin e respektimit të të drejtave themelore të azilkërkuesve nga autoritetet e Republikës së Kosovës në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm të Republikës së Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të mishëruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ekipi monitorues i MKP-së dhe i organizatave të lartcekura, gjatë kohës së vizitave ka evidentuar se në Qendrën për Azilkërkues në Magure ishin të vendosur 27 azilkërkues, ndërsa në banim privat ishin 30-40 persona. Ndërsa në Qendrën për Azilkërkues në Vranidoll nuk kishte persona të akomoduar. Në vitin 2021, Avokati i Popullit kishte rekomanduar që të evitohen mangësitë në funksionimin e sistemit të kanalizimit në Qendrën për Azilkërkues në Vranidoll. Grupi monitorues, gjatë vizitës së fundit, ka vërejtur se në këtë qendër ishin kryer renovimet dhe rekomandimi ishte implementuar.

Bazuar në statistikat e Qendrës, numri i azilkërkuesve krahasuar me vitet paraprake, ishte

në rënie. Gjatë vitit 2022 numri i azilkërkuesve ishte rreth 518 persona, kryesisht nga Maroku, Siria, Afganistani, Algjeria.

Për sa u përket fëmijëve azilkërkues, ekipi i MKP-së gjatë vizitës në Qendrën për Azilkërkues në Magure (maj 2022) u njoftua se kishte familje me fëmijë, por nuk kishte fëmijë të pashoqëruar. Mirëpo, sipas njoftimit të fundit të datës 30 nëntor 2022, janë regjistruar gjithsej 22 të mitur të pashoqëruar.

Neni 31 i Rregullores nr. 03/2018 për Funksionimin e Qendrës për Azil përcakton se interesi më i mirë i fëmijëve duhet të merret në konsideratë gjatë zbatimit të Rregullores. Sipas Rregullores, fëmijëve të cilët kanë qenë viktimë e çfarëdo forme të abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit, torturës ose trajtimit çnjerëzor dhe johuman, ose që kanë vuajtur nga konfliktet e armatosura, do t'u ofrohen shërbime adekuate të trajtimit shëndetësor dhe këshillime të kualifikuara, kur është e nevojshme. Po ashtu, sipas Rregullores, fëmijëve të akomoduar në Qendër do t'u sigurohet qasje në aktivitete zbavitëse dhe në lojëra, në pajtim me moshën e tyre.

Njoftimi për të drejtat themelore të azilkërkuesve - MKP-ja ka vërejtur se azilkërkuesit informohen për të drejtat e tyre dhe për procedurat e azilit përmes broshurave dhe dokumenteve të shkruara në gjuhën arabe, angleze, frënge, turke, serbe etj. Përveç kësaj, në korridoret e Qendrës për Azilkërkues në Magure janë instaluar ekrane të mëdha, ku përmes tyre azilkërkuesit informohen për të drejtat e tyre në gjuhën shqipe, angleze dhe arabe.

Trajtimi - Gjatë vizitës, grupi monitorues i MKP-së dhe i CRPK-së kanë intervistuar azilkërkuesit përmes përkthyeses së gjuhës arabe. Të gjithë azilkërkuesit janë shprehur në favor të një trajtimi shumë të mirë dhe human nga zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nga Policia e Kosovës.

Kushtet e akomodimit në qendrat për azilkërkues - MKP-ja ka vërejtur se kushtet e akomodimit janë të një standardi shumë të mirë në kuptim të hapësirës për banim, ndriçimit, pastërtisë dhe ngrohjes. Për sa u përket aktiviteteve sociale dhe të edukimit, grupi monitorues konsideron se Qendra për Azilkërkues në Magure i plotëson të gjitha kushtet për aktivitete sociale dhe edukative. Në Qendrën për Azilkërkues në Vranidoll, grupi monitorues vërejtë se në oborr ekziston këndi i lojës për fëmijë.

Kujdesi shëndetësor - MKP-ja ka vërejtur se shërbimet mjekësore për të huajt në Qendrën e Azilit u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare më e afërt dhe nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Përveç kësaj, MKP-ja ka vërejtur se një mjek u angazhua nga Jezuit Refugee Service (JRS), i cili qendrat për azilkërkues i furnizonte me barna dhe me materiale të tjera të nevojshme. MKP-ja nuk ka marrë ankesa nga azilkërkuesit për sa u përket shërbimeve mjekësore, përkundrazi, azilkërkuesit kanë pohuar se shërbimet e nevojshme u jepën në afat sa më të shpejtë.

Shërbimet psikologjike ofrohen nga organizata Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT). Psikologu gati çdo ditë është i pranishëm në Qendër dhe u ofron trajtime individuale dhe grupe.

Kontaktet me botën e jashtme - Sipas Rregullores, azilkërkuesve u lejohet të pranojnë vizita në Qendër, të pranojnë pako dhe korrespondencë, ta përdorin telefonin e Qendrës për të komunikuar sipas orarit

të caktuar, si dhe të dalin nga Qendra nga ora 7:00 deri në orën 22:00.⁶³ Po ashtu, Rregullorja përcakton se Komisariati i Lartë i OKB-së për Refugjatë (UNHCR), Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), si dhe organizatat e ndryshme joqeveritare kanë qasje në Qendër. Avokati i Popullit dhe bashkëpunëtorët e tij kanë qasje dhe komunikim të pakufizuar me aplikuesit e Qendrës.⁶⁴ Për më shumë, në dispozicion të azilkërkuesve është edhe lidhja me internet përmes WI-FI, e cila është në dispozicion të azilkërkuesve gjatë gjithë kohës.

Procedura e parashtrimit të ankesave - Çështja e parashtrimit të ankesave është e rregulluar me nenin 43 të Rregullores, ku përcaktohet se azilkërkuesi ka të drejtë t'i parashtrorë ankesë udhëheqësit lidhur me kushtet e pranimit dhe të trajtimit nga zyrtarët e Qendrës. Ankesa më pas dërgohet në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migrim, në kuadër të MPB-së, në afat prej 7 ditësh. MKP-ja ka vërejtur se në dispozicion të azilkërkuesve në Qendër është një kuti e ankesave e vendosur nga Qendra.

Po ashtu, Ligji për Azil dhe Rregullorja garantojnë qasje të papenguar për organizatat ndërkombëtare dhe për OJQ-të vendore. Grupi monitorues, gjatë vizitës, përmes përkthyesit të gjuhës arabe, sërish i njoftoi azilkërkuesit për rolin dhe mandatin e Institucionit të Avokatit të Popullit, si organ shtetëror, i cili mbron dhe promovon të drejtat themelore të njeriut dhe mundësinë që t'i drejtohen Institucionit lidhur me shqetësimet e tyre.

QENDRA E MBAJTJES PËR TË HUAJ

Bazuar në mandatin ligjor, MKP-ja më 19 maj dhe më 30 qershor 2022 së bashku me përfaqësuesit e Komisarariatit të Lartë për Refugjatë i Organizatës së

63 Rregullorja (MPB) nr. 03/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Azil, nenet 38, 39, 42 dhe 54.

64 Rregullorja (MPB) nr. 03/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Azil, neni 54.

Kombeve të Bashkuara (UNHCR) dhe përfaqësues të Civil Rights Program Kosova (CRPK) ka vizituar Qendrën e Mbajtjes për të Huajt (QMH).

QMH-ja funksionon në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DShAM) i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Sipas nenit 2 të Rregullores (MPB) nr. 04/2018 për Funksionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve (në tekstin e mëtejme: Rregullorja), në këtë qendër vendosen të huajt të cilët janë subjekt i largimit me forcë, si dhe të huajt për të cilët konsiderohet se e cenojnë sigurinë publike, me qëllim të vërtetimit të identitetit të tyre dhe për arsye të tjera. Kapaciteti i QMH-së është për 70 persona, ndërsa gjatë vizitës së bërë nga MKP-ja ishin të pranishëm 3 të huajt.

Trajtimi

Gjatë vizitës së realizuar nga MKP-ja në QMH, ishin të pranishëm 3 persona të huajt të ndaluar. MKP-ja ka kontrolluar dosjet e tyre dhe ka realizuar intervista grupore përmes përkthyesit të gjuhës arabe. MKP-ja nuk ka marrë asnjë ankesë nga personat e intervistuar për keqtrajtim fizik, përdorim të tepruar të forcës fizike apo për sjellje jokorrekte nga zyrtarët e sigurisë dhe zyrtarët e QMH-së. Përkundrazi, të huajt në ndalim u shprehën në favor të një trajtimi shumë të mirë nga Policia e Kosovës dhe nga zyrtarët e MPB-së.

Mirëpo, ekipi i MKP-së, në vizitën e realizuar më 30 qershor 2022 në QMH, ka vizituar të huajin E. T., i cili ishte i akomoduar në QMH së bashku me djalin e tij, O. T. Gjatë vizitës MKP-ja ka intervistuar E. T., i cili nuk kishte ankesa për sa u përket kushteve dhe trajtimit në QMH. Ankuesi shprehu shqetësimin se

djali tij, O. T., gjatë qëndrimit në Qendrën e Azilit është bullizuar nga një banor tjetër në atë qendër.⁶⁵

Lidhur me këtë çështje MKP-ja ka shqyrtuar dokumentacionin për rastin O. T., përfshirë dosjen shëndetësore, raportin e policisë dhe vendimet e gjykatës. Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, MKP-ja nuk ka vërejtur shenja të keqtrajtitimit fizik. Po ashtu, MKP-ja ka kontaktuar edhe me avokaten e autorizuar, që e ka përfaqësuar palën në gjykatë, e cila ka pohuar se gjatë gjithë mbrojtjes në gjykatë, pala nuk ka shprehur shqetësim për keqtrajtim dhe nuk janë vërejtur shenja të keqtrajtitimit fizik.

Kushtet e akomodimit - MKP-ja konsideron se kushtet e akomodimit në QMH janë në nivel shumë të mirë. Të gjitha dhomat ofronin akomodim të denjë, ngrohje, ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial, si dhe dushe të cilat ishin në gjendje shumë të mirë. Të huajt në QMH mund të kenë qasje në dushe sa herë që ata duan.

Kujdesi shëndetësor - Për sa u përket shërbimeve shëndetësore, Ligji 04/L-219 për të Huajt përcakton se QMH-ja duhet t'i plotësojë të gjitha kushtet e një trajtimi të dinjitetshëm si dhe respektimin e të drejtave njerëzore, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe të mundësojë ofrimin e shërbimeve shëndetësore.⁶⁶

Më tej Rregullorja përcakton se i huaji, gjatë qëndrimit në QMH, ka të drejtë për shërbime mjekësore. Sipas Rregullores, personeli mjekësor kryen ekzaminimin e përgjithshëm mjekësor të të huajit, i cili ndalohet në QMH.⁶⁷

Të huajve që mbahen në QMH, shërbimet mjekësore u jepen nga Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, sipas nevojës, dërgohen për shërbime

65 Raporti i Avokatit të Popullit me Rekomandim për Qendrën për të Huajt në Vranidoll <https://oik-rks.org/2022/07/26/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-e-mbajtjes-per-te-huajt-ne-vranidoll/>

66 Ligji 04/L-219 për të Huajt, neni 107, paragrafi 2.

67 Neni 13 i Rregullores nr. 04/2018 për Funksionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18342>

spitalore regjionale dytësore apo edhe në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), ku u ofrohen edhe shërbimet shëndetësore terciare. Kjo pasi QMH-ja ende nuk ka personel mjekësor, edhe pse MKP-ja, përmes raporteve të mëhershme, kishte rekomanduar që QMH-ja ta ketë në dispozicion së paku një infermier/e. Grupi monitorues gjatë vizitës së fundit ka vërejtur nga shikimi i dosjeve, se për trajtimin e një rasti, që ishte vështirë i menaxhueshëm, i është ofruar ndihmë nga IOM-i. Ndërsa, për sa u përket shërbimeve psikologjike, të cilat parashihen me nenin 41 të Rregullores, MKP-ja ka vërejtur se ato ofrohen nga psikologu i kontraktuar nga IOM-i.

Kontakti me botën e jashtme - Sipas nenit 25 të Rregullores nr. 04/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Mbatjen e të Huajve, i huaji në mbajtje ka të drejtë të mbajë korrespondencë, të pranojë pako dhe sende të tjera. Po ashtu, të huajve në mbajtje u lejohej të pranojnë vizita.⁶⁸

Rregullorja nr. 04/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Mbatjen përcakton se i huaji ka të drejtë të bëjë telefonata sipas nevojës në kohëzgjatje prej 5 minutash, duke filluar nga ora 9:00 deri në orën 16:00, çdo ditë pune.⁶⁹ Sipas Rregullores, të huajve u mundësohen edhe thirrjet nga jashtë. Gjatë vizitës, grupi monitorues ka vërejtur se të huajt mund t'u telefononin familjeve të tyre. Grupi monitorues konsideron se meqenëse është fjala për paraburgim administrativ dhe për paraburgim, në kuptim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të ndaluarve duhet t'u ofrohen edhe mundësi të tjera për komunikim me botën e jashtme, siç janë: komunikimet *online*

përmes SKYPE apo edhe përmes sistemeve të tjera të komunikimit.

Monitorimi dhe mekanizmat e ankimit - Ekipi i MKP-së vëren se të huajt kanë të drejtë ankese tek udhëheqësi i QMH-së, lidhur me kushtet e pranimit në QMH dhe sjelljet e personelit. Ankesa shqyrtohet nga DShAM-ja. Sipas Rregullores nr. 04/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Mbatjen e të Huajve. Qendra e Mbatjes për të Huaj ka të vendosur kutinë e ankesave, e cila administrohet nga vetë qendra.

Ndërsa, për sa i përket monitorimit, përveç MKP-së, të huajt në QMH mund të vizitohen në çdo kohë nga UNHCR-ja, IOM-i, KPT-ja, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar. Rregullorja parasheh se udhëheqësi i kësaj qendre mund t'u japë të drejtë qasjeje në QMH edhe institucioneve apo organizatave të tjera relevante.⁷⁰ Po ashtu të huajt në mbajtje mund t'i drejtojnë ankesat e tyre tek Avokati i Popullit. Gjatë vizitës, MKP-ja u ka shpërndarë të huajve në mbajtje broshura në gjuhën angleze, serbe, turke dhe arabe, të cilat përmbajnë hollësi se si ata mund të kontaktojnë me Avokatin e Popullit dhe t'i parashirojnë ankesat e tyre.

Avokati i Popullit, lidhur me vizitën e MKP-së në Qendrën e Mbatjes për të Huaj, ka publikuar raportin me rekomandim, më 25 korrik 2022.⁷¹

68 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18342>

69 Neni 26 i Rregullores nr. 04/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Mbatjen e të Huajve <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18342>

70 Neni 27 i Rregullores nr. 04/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Mbatjen e të Huajve.

71 Raporti i Avokatit të Popullit për Qendrën e Mbatjes për të Huaj në Vranidoll <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2022/07/Raport-p%3Abr-vizit%3Abn-n%3Ab-Qendr%3Abn-e-Mbatjes-p%3Abr-t%3Ab-Huaj-n%3Ab-Vranidoll-25-korrik-2022.pdf>

MONITORIMI I OPERACIONEVE TË KTHIMIT ME FORCË PËRMES LINJAVE AJRORE

Gjatë vitit 2022, ekipi i MKP-së, në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës ka monitoruar një operacion të kthimit me forcë të një shtetasi të Republikës së Kosovës dhe një të Republikës së Shqipërisë nga autoritetet zvicerane. Ky monitorim bazohet në Memorandumin e Mirëkuptimit i nënshkruar ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Komisionit Nacional Zviceran për Parandalim të Torturës.⁷²

Gjatë monitorimit të operacioneve në fjalë, MKP-ja i ka intervistuar të kthyerit dhe ka vërejtur se të kthyerit me forcë janë trajtuar në mënyrë humane dhe korrekte nga autoritetet policore të Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, MKP-ja ka hasur në bashkëpunim të plotë të Policisë së Kosovës gjatë realizimit të këtyre operacioneve.

Qendrat e Mbajtjes për të Huaj dhe Qendra e Azilit të vizituara në vitin 2022

Institucioni i vizituar	Nr. i vizitave
1. Qendra e Azilit	2
2. Qendra e Mbajtës për të Huaj	2
3. Qendra e pritjes për Azilkërkues dhe Migrantë në Vranidoll	1
4. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtine	1

⁷² Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Komisionit Nacional Zviceran për Parandalim të Torturës për monitorim të operacioneve të kthimit me forcë, i nënshkruar më 24 prill 2019. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/04/25/nenshkruhet-memorandumi-i-mirekuptimit-ne-mes-te-zvices-dhe-kosoves-per-paranda-lim-te-tortures-dhe-monitorim-te-perbashket-te-operacioneve-te-kthimit-me-force/>

KAPITULLI V

V. INSTITUCIONET E SHËNDETIT MENDOR DHE ATO TË KUJDESIT SOCIAL

Avokati i Popullit, nëpërmjet mekanizmit të tij, vëzhgon rregullisht me anë të vizitave të rregullta në terren, respektimin e të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime mendore në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor.⁷³

Gjatë vitit 2022, MKP-ja ka vizituar Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (tani e tutje: IPFK), Repartin e Urgjencës dhe të Kujdesit Intensiv Psikiatrik të Klinikës Psikiatrike (tani e tutje: UKIP), Qendrën për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë në Shtime (QIRSKP), Shtëpinë Integruese në Bashkësi në Bresje dhe në Ferizaj, Institutin Special në Shtime, Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore në Shtime, Shtëpitë me Bazë në Komunitet në Shtime, në Ferizaj dhe në Prizren.

Gjatë vizitave në institucionet e shëndetit mendor, MKP-ja nuk ka marrë ankesa për keqtrajtim të pacientëve nga personeli i institucioneve në fjalë. Në të gjitha institucionet e vizituara, atmosfera e përgjithshme ishte e relaksuar, ndërsa raportet ndërmjet personelit dhe pacientëve ishin të mira.

Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës

Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës (IPFK) është njësi organizative e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK-së). Sipas Ligjit për Shëndetin Mendor, ofron shërbime të nivelit terciar për tërë vendin (i vetmi në Kosovë).⁷⁴

Gjatë vizitës së fundit nga MKP-ja (shtator 2022), në secilin repart kapaciteti ishte i plotësuar. Kapaciteti në total është 36 shtretër (nga 12 shtretër në secilin repart), ndërsa gjatë vizitës së MKP-së, sipas dosjeve ishin të vendosur rreth 40 pacientë, prej të cilëve disa ishin në vikend terapeutik. Në listë të pritjes për këto reparte janë edhe disa raste të tjera.

Trajtimi dhe aktivitetet - MKP-ja gjatë vizitës nuk mori ankesa për keqtrajtim fizik, mirëpo as nuk vërejti shenja të dhunës fizike tek pacientët. Ekipi intervistoi pacientët e pranishëm, të cilët pohuan për një trajtim të duhur nga stafi mjekësor.

Në IPFK, përveç vlerësimit, trajtimit me medikamente, ofrohen edhe aktivitete psiko-sociale. Trajtimi psiko-social konsiston në aktivitete, si: lojëra, shikim televizori, vizatime, daljet ditore

⁷³ Neni 30 i Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor.

⁷⁴ Ligji nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, neni 13, paragrafi 1.2.

brenda institucionit (në shëtitore të IPFK-së), seanca individuale dhe grupe me psikologun etj.

MKP-ja ndër vite ka vërejtur se trajtimi në thelb është me farmakoterapi. Në raportin e fundit të MKP-së së Avokatit të Popullit, i publikuar në gusht 2018, për vizitën në IPFK, është potencuar: *“Është përgjegjësi e institucionit dhënia e medikamenteve të caktuara sipas evidencave të njohura por edhe aplikimi i monitorimit të efekteve anësore të tyre të mundshme sipas praktikave të pranuar klinike (analizat përcjellëse tek aplikimi i Clozapinës).”*

Në raportin e fundit të KPT-së për Kosovën (publikuar më 23 shtator 2021)⁷⁵, sipas gjetjeve të tyre, trajtimi konsiston në farmakoterapi dhe se planet individuale të trajtimit nuk ishin hartuar sistematikisht dhe nuk kishte regjistrim të duhur të vlerësimit dhe progresit në dosjet mjekësore të pacientëve. Sipas tyre, dosjet e pacientëve, të shikuara nga delegacioni, ishin elementare, pa asnjë informacion për historinë mjekësore (zhvillimi i simptomave, trajtimi i mëparshëm dhe rezultatet, tiparet e veçanta të personit ose sëmundja) dhe mungonte përshkrimi i situatës sociale të pacientit. Për më tepër, diagnozat dhe trajtimi i pacientëve nuk ishin të arsyetuara siç duhet. Edhe në Raportin e fundit të Avokatit të Popullit, publikuar më 30 nëntor 2022, për vizitën në Institutin e Psikiatrisë Forenzike, MKP-ja ka inkurajuar stafin e IPFK-së që t’u japin rëndësi rekomandimeve të KPT-së lidhur me farmakoterapinë dhe qasjen shumëdisiplinore.

Kushtet e akomodimit - kushtet materiale në IPFK janë deri diku të mira. Vlen të ceket se inventari është demoluar, sidomos në pjesën e qëndrimit ditor. Në Repartin B, kur të lëshohen klimat, pikon ujë në korridore, në një dhomë në Repartin B kishte lagështi, dyshekët në përgjithësi nuk janë të mirë, dyert e dhomave nuk janë të sigurta dhe janë me xhama transparentë. Dy dhomat e izolimit në

Repartin C, për shkak të kushteve jo të mira, janë jashtë funksionit, kamerat nuk punojnë, xhami i derës së dhomës ishte i thyer. Kushtet higjienike janë në rregull, pacientët kanë qasje në dritë natyrale, ventilim si dhe privatësia në dushe dhe në tualete ishte në nivelin e duhur.

Hapësirat e vizitave familjare në të gjitha repartet janë në korridore, pa dyer, ku nuk sigurohet privatësia dhe janë të vrazhda, si për pacientin po ashtu edhe për familjarin. Pjesa ku realizohen vizitat familjare në Repartin C ishte një dhomë shumë e vogël pa dritare, e erret, me një tavolinë me dy karrige dhe privatësia nuk ishte në nivelin e duhur.

MKP-ja, edhe në raportin me rekomandime të fundit për IPFK-në, shpreh shqetësim se IPFK-ja nuk ka një repart të veçantë për pacientet femra dhe për të mitur dhe kur ka raste të gjinisë femërore, pacientët e gjinisë mashkullore dhe femërore rrinë në hapësira të përbashkëta.

Në raportin e fundit me rekomandime për vizitën në Institutin e Psikiatrisë Forenzike⁷⁶, Avokati i Popullit ka kërkuar nga autoritetet kompetente që sa më shpejt të ndër marrin masa në rritjen e kapaciteteve dhe krijimin e kushteve për pacientët e të dy gjinive si dhe për të miturit, në mënyrë që t’u mundësohet pacientëve të përfitojnë në mënyrë efektive nga qasja në mjediset e jashtme, çdo ditë (me mbikëqyrjen e duhur dhe/ose siguri nëse kërkohet).

Kontakti me botën e jashtme - Vizitat familjare realizohen dy herë në javë nga 30 minuta. Përpos vizitave, pacientët kanë të drejtë edhe për telefonata. IPFK-ja i praktikon edhe vikendet terapeutike, gjë e cila deri më tani është treguar e suksesshme. MKP-ja nuk ka marrë ankesa nga pacientët për kontakt me botën e jashtme.

⁷⁵ Shih raportin, <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/the-cpt-publishes-report-on-kosovo>.

⁷⁶ <https://oik-rks.org/2022/11/30/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-institutin-e-psikiatrise-forenzike/>

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore - MKP-ja gjatë vizitave të realizuara gjatë vitit 2022 ka vërejtur se shërbimet mjekësore pacientëve në IPFK u jepen pa praninë e zyrtarëve të sigurimit, përveç nëse personeli mjekësor në raste të caktuara shprehimisht e kërkon një gjë të tillë.

Parandalimi i vetëvrasjeve - Sipas pohimeve të stafit, përgjatë viteve të fundit nuk kanë pasur raste të vdekjeve apo vetëvrasjeve në IPFK. Gjatë vizitës së fundit nga MKP-ja u vërejt se gjatë vitit 2022 është zbatuar rekomandimi i dhënë në vitin 2018 për sa u përket protokolleve. IPFK-ja së fundmi kishte përpiluar: *Protokollin e vlerësimit dhe trajtimit të pacientëve që shfaqin rrezik potencial për vetëvrasje; Protokollin e parandalimit dhe menaxhimit të sjelljes së çrregulluar/violente dhe Protokollin e vlerësimit dhe trajtimit të pacientëve që shfaqin sjellje vetë lënduese*. Këto protokolle janë verifikuar edhe nga ekipi i MKP-së.

Mjetet e kufizimit - MKP-ja gjatë vizitës vërejt se nuk përdoret kufizim mekanik. Në repart është një këmishë për fiksion mekanik, por nuk është përdorur asnjëherë. Dhoma e izolimit është mjete kryesor dhe i vetmi mjet i kufizimit. Gjatë vizitës MKP-ja vërejt formularin e monitorimit të izolimit, ku stafi, pas monitorimit, çdo 15-30 minuta e nënshkruan formularin në fjalë. Pas përfundimit të masës së izolimit, formulari futet në dosjen e pacientit.

MKP-ja e Avokatit të Popullit, edhe në raportin e fundit, publikuar më 28 gusht 2018, e kishte adresuar problematikën se përdorimi i dhomave të izolimit ishte i tepruar dhe me kohëzgjatje që nuk mund të arsyetohej. MKP-ja e Avokatit të Popullit vërejt se ende nuk ka protokoll specifik për përdorimin e mjeteve të kufizimit për institucionet psikiatrike, ashtu siç kërkohet sipas nenit 27 të Ligjit për Shëndetin Mendor, paragrafët 2 dhe 3.

Edhe KPT-ja, në raportin e fundit për vizitën në Kosovë, lidhur me Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK) dhe me Klinikën Psikiatrike, kishte theksuar se izolimi i pacientëve ishte një praktikë e shpeshtë, zakonisht e kombinuar me administrimin me forcë të ilaçeve (me përmbajtje kimike). KPT-ja kujton se përdorimi i mjeteve të kufizimit duhet të jetë subjekt i një politike gjithëpërfshirëse dhe kishte dërguar një numër rekomandimesh specifike në këtë drejtim.⁷⁷

Stafi në IPFK - MKP-ja konsideron se IPFK-ja ka staf të mjaftueshëm. Për sa u përket trajnimeve, stafi vetëm në fillim ka pasur një trajnim bazik kapje/kontrolle për menaxhimin e rasteve të vështira dhe asnjëherë tjetër nuk janë realizuar trajnime të tilla për stafin. Gjatë vizitës së fundit MKP-ja u njoftua se stafi shëndetësor i IPFK-së i ka dhënë informata bazike personelit të sigurisë së brendshme se si t'i menaxhonte rastet në krizë.

Rishikimi i vendimeve nga gjykatat kompetente - Për sa u përket vendimeve të gjykatës, sikurse edhe në vitet e kaluara, MKP-ja edhe gjatë vitit 2022 u informua se po vazhdon problemi i njëjtë, ku drejtori i IPFK-së pretendon se problem shtesë përbën mosndryshimi i masës nga gjykatat kompetente, pavarësisht arritjes së objektivave për trajtim të atyre rasteve. Sipas drejtorit të IPFK-së, ata kanë bërë kërkesë për disa persona që t'iu ndërrohet masa, por nuk kanë marrë përgjigje nga gjykatat.

Procedura e parashtrimit të ankesave - Procedura efektive për parashtrim të ankesave është garanci themelore kundër keqtrajtimit në institucionet psikiatrike. Gjatë vizitave të fundit, MKP-ja vërejt se në Psikiatrinë Forenzike dhe në reparte të Klinikës Psikiatrike ekzistojnë kutitë e ankesave për pacientë, të cilat nuk ishin të emëruara siç duhet, e që sipas drejtorisë, ato kuti hapen nga një zyre

⁷⁷ Shih raportin e KPT-së për vizitën e fundit në Kosovë, paragrafët 139, 140: <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/the-cpt-publishes-report-on-kosovo>.

përgjegjëse në kuadër të QKUK-së. Megjithatë, për MKP-në është e paqartë procedura e parashtrimit të ankesës së pacientit, nga kush hapen ato kuti, kush i trajton ankesat. Pra MKP-ja gjatë vitit 2022 i është drejtuar me e-mail ShSKUK-së për t'i kërkuar informata, mirëpo institucioni në fjalë nuk është përgjigjur asnjëherë.

Lidhur me të gjeturat në Institutin e Psikiatrisë Forenzike, Avokatit i Popullit përmes raportit me rekomandime, publikuar më 30 nëntor 2022⁷⁸, u është drejtuar autoriteteve përgjegjëse, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje brenda afatit ligjorë nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga Ministria e Drejtësisë. Mirëpo përgjigjet e Ministrisë së Shëndetësisë, konkretisht të drejtorit të IPFK-së, ishin përgjigje gjithëpërfshirëse, duke potencuar si në vijim: *“Rekomandimet e dhëna në këtë raport do ti bëjmë kërkesë dhe shtytje të gjithë akterëve në plotësimin e këtyre rekomandimeve, pasi që do të krijohen kushtet bazike dhe ligjore të funksionimit të IPFK-së, ndërsa ato të cilat janë në kompetencën tonë do të implementojmë.”*⁷⁹

Klinika e Psikiatrisë në Prishtinë - Reparti i Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKP-ja e Avokatit të Popullit, më 19 gusht dhe më 29 shtator 2022, ka vizituar Klinikën e Psikiatrisë ku vëmendje e veçantë i është kushtuar repartit të Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik (në tekstin e mëtejme “UKIP”). Gjatë vizitës, personeli shëndetësor i ofruan ekipit monitorues të MKP-së bashkëpunim të plotë, qasje të papenguar në çdo

hapësirë dhe iu mundësuan bisedat me pacientët pa prezencë të personelit mjekësor.

Legjislacioni relevant – Në bazë të Ligjit për Shëndetësinë, nenit 13 të Ligjit për Shëndetin Mendor të Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të Statutit të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (në tekstin e mëtejme: ShSKUK), Klinika Psikiatrike është njësi organizative e ShSKUK-së. Ajo sipas ligjit në fuqi ofron shërbime të nivelit terciar për tërë vendin (e vetmja klinikë në Kosovë), por është e detyruar të ofrojë edhe shërbime të nivelit sekondar për regionin e Prishtinës, në mungesë të një spitali të përgjithshëm. Të gjitha repartet (përveç repartit të Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik) janë të hapura dhe bëjnë trajtimin me vullnetin e pacientëve dhe në raste të caktuara edhe pa vullnetin e tyre bazuar në vendimin e gjykatës kompetente.

Dispozitat ligjore përkatëse për vendosjen e pavullnetshme të natyrës civile rregullohen me Ligjin për Shëndetin Mendor (LSHM) (nenet 20-24), i cili u miratua në vitin 2015, dhe me Ligjin për Procedurat Jokontestimore (nenet 75 deri në 96).

Klinika e Psikiatrisë në Prishtinë - është e vendosur brenda hapësirës së ShSKUK-së, ka një sipërfaqe prej 3860 m². Kapaciteti i saj përbëhet prej 85 shtretërve. Klinika Psikiatrike përbëhet nga 4 reparte të ndara: Reparti A, ku trajtohen aktualisht të gjitha çrregullimet psikotike; Reparti B, për çrregullimet afektive/personalitetit; Reparti i Sëmundjeve të Varësisë (RSV), ku trajtohen të gjitha rastet e varësisë nga alkooli, barnat e përshkruara, substancave narkotike (Kokaina, Heroin etj.); Reparti i mbyllur i Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik (në tekstin e mëtejme: UKIP) si dhe shërbimi psikiatrik për fëmijë dhe adoleshentë.

78 Po aty. <https://oik-rks.org/2022/11/30/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-institutin-e-psikiatrise-forenzike>

79 Përgjigje e protokolluar me nr.518/2022, datë 29.12.22.

Klinika Psikiatrike nuk ka repart për trajtim të të moshuarve, fëmijëve dhe adoleshentëve, në repartet e lartcekura trajtohen pacientët nga moshë 18-65. Megjithatë, vendosja e të miturve dhe e të moshuarve është praktikë gati e përhershme dhe në njëfarë mënyre e detyruar, për shkak se për të miturit nuk ka shtretër tek Psikiatria për Fëmijë dhe Adoloshentë dhe po ashtu edhe për të moshuarit nuk kanë hapësira të tjera hospitalizimi. Në Rregulloren nr.127/2015, e datës 21.12.2015, për pranimin dhe trajtimin e personave me çrregullime mendore në ShSKUK (neni 11) lejohet që një person që nga moshë 16-vjeç mund të hospitalizohet. Sipas njoftimit të drejtorit të Klinikës së Psikiatrisë, shërbimi psikiatrik për fëmijë dhe adoleshentë do të bëhet me shtretër. MKP-ja e Avokatit të Popullit do t'i ndjekë veprimet e autoriteteve lidhur me këtë çështje edhe gjatë vitit 2023.

Në Repartin e Sëmundjeve të Varësisë (RSV), gjatë vizitës së MKP-së në vitin 2018, ka vërejtur se nuk ka dhoma të mjaftueshme për trajtim të pacientëve (vetëm 6 shtretër). Gjatë vizitës së fundit (shtator 2022), MKP-ja u njoftua nga drejtori i Klinikës se është vënë në funksion pjesa e re e repartit të RSV, me kapacitet 12 shtretër. MKP-ja përsëritet këtë arritje të Klinikës Psikiatrike, megjithatë nuk është zgjidhje e plotë ky repart për personat e varur nga drogat, pasi pacientët qëndrojnë në këtë repart deri në 2 javë të hospitalizuar dhe pas përfundimit të detoksimit, trajtimi vazhdon në rrethin familjar.

Personeli i Klinikës Psikiatrike – Personeli në të gjithë Klinikën Psikiatrike përbëhet nga 25 psikiatër, 47 infermierë, 3 psikologë në Klinikë Psikiatrike dhe 3 në Psikiatrinë e Fëmijëve dhe Adoloshentëve. Drejtori thekson se ka disa vite që punëtorja sociale është pensionuar dhe nuk është zëvendësuar. Mungesa e punëtorit social po shkakton vështirësi në punë sidomos për rastet e

trajtimin të pavullnetshme në repartin UKIP. MKP-ja, edhe në Raportin me rekomandime lidhur me vizitën në Klinikën Psikiatrike të ShSKUK-së⁸⁰, e ka potencuar se punëtorja sociale është pensionuar dhe nuk është zëvendësuar asnjëherë. Avokati i Popullit do të vazhdojë me monitorim edhe gjatë vitit 2023 dhe do të dalë me rekomandime konkrete për Klinikën Psikiatrike.

Reparti i urgjencës dhe kujdesit intensiv psikiatrik (në tekstin e mëtejshëm: "UKIP") - është njësi e mbyllur dhe funksionon në kuadër të Klinikës Psikiatrike. Në këtë repart trajtohen rastet e çrregullimeve të ndryshme psikotike, të çrregullimeve bipolare dhe të çrregullimeve të personalitetit, që nuk mund të trajtohen në repartet e tjera të hapura. Ky repart është i vetmi në tërë territorin e Kosovës. Në spitalet e tjera regjionale, repartet psikiatrike nuk i kanë funksionale dhomat e veçanta ku trajtohen rastet urgjente. Rastet e tilla nga tërë Kosova sillen në repartin UKIP të Klinikës Psikiatrike në Prishtinë. MKP-ja konsideron se repartet psikiatrike në spitalet e tjera regjionale duhet t'i aktivizojnë dhomat e veçanta për trajtimin e rasteve urgjente.

MKP-ja, edhe përmes këtij raporti, konsideron se repartet psikiatrike në spitalet e tjera regjionale duhet t'i aktivizojnë dhomat e veçanta për trajtimin e rasteve urgjente. MKP-ja, përmes raportit me rekomandime në vitin 2018⁸¹, u ka rekomanduar autoriteteve kompetente aktivizimin e këtyre dhomave të veçanta për trajtim të rasteve urgjente, mirëpo gjendja mbetet e njëjtë dhe ky rekomandim nuk është zbatuar ende.

MKP-ja u njoftua se pacientët në përgjithësi sillen në repartin UKIP nga familjarët ose policia dhe janë pacientë të cilët akomodohen pa vullnetin e tyre. Sigurimi në repartin UKIP ofrohet nga sigurimi privat, të cilin e kryenin dy persona.

80 Shih Raportin për vizitën në Klinikën Psikiatrike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, i publikuar më 26 tetor 2018, <https://oik-rks.org/2018/10/29/raport-me-rekomandime-lidhur-me-viziten-ne-klinikene-psikiatrike-ne-qkuk/>

81 MKPT, Raport me rekomandime për vizitën në Klinikën Psikiatrike në Prishtinë, publikuar më 26 tetor 2018. Shih në: <https://www.oik-rks.org/2018/10/29/raport-me-rekomandime-lidhur-me-viziten-ne-klinikene-psikiatrike-ne-qkuk/>.

Edhe pse intervenimi në raste të incidenteve nuk është mandat i sigurimit, ata janë ftuar disa herë nga personeli mjekësor për të intervenuar. MKP-ja konsideron se është e rëndësishë qenësore që personeli i cili caktohet në detyra të ndërlidhura me sigurinë në një institucion psikiatrik, të përzgjidhet në mënyrë të kujdesshme dhe t'u nënshtrohet trajnime adekuate para se t'i marrë përsipër detyrat e veta. Po ashtu, ata gjatë kryerjes së detyrave duhet të mbikëqyren për së afërmi dhe t'i binden autoritetit të personelit të kualifikuar mjekësor.

Sipas drejtorit, pas pranimit të pacientit, brenda 24 orëve bëhet vlerësimi i gjendjes së tij/saj shëndetësore nga një komision mjekësor neutral prej tre anëtarësh (të cilët nuk janë staf i UKIP) dhe vlerësojnë rastin a është për trajtim të pavullnetshëm në UKIP apo për reparte të hapura në Klinikën Psikiatrike.

Avokati i Popullit ndër vite e ka përmendur në raportet me rekomandime⁸² se trajtimi i personave me çrregullime mendore në veçanti sfidohet nga mungesa e akteve nënligjore të Ligjit për Shëndetin Mendor dhe të cilat janë paraparë që të miratohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Qeveria e Kosovës. Avokati i Popullit ripërsërit rekomandimin që të nxirren aktet nënligjore të Ligjit për Shëndet Mendor, në mënyrë që ligji të jetë i zbatueshëm dhe funksional.

Kushtet e akomodimit në UKIP - Kapaciteti i këtij reparti është 14 shtretër, ndërsa reparti është i ndarë në dy krahë: 7 shtretër për meshkuj dhe 7 shtretër për femra. MKP-ja ka vërejtur se muret ka kohë që nuk janë lyster, disa xhama të dritareve janë të krisura, dritaret kanë grila hekuri, banjat kanë lagështi, banja e femrave është jashtë funksionit për shkak rrjedhjes së ujit. Në kuzhinën e repartit

ka lagështi. Dhomat janë me nga dy shtretër, me hapësirë të përshtatshme, me dritë dhe ajrosje dhe janë të ngruhta. Hapësirat e dhomave nuk kanë dekorime, disa piktura janë në mure të dhomës së ditës dhe ushqimit. Janë 4 dhoma të izolimit, janë të demoluara, nuk kanë ventilim. Drejtori i Klinikës i ka rregulluar muret e dy dhomave të izolimit, mirëpo MKP-ja po ashtu ka vërejtur se dhomat e izolimit janë larg personelit shëndetësor dhe butoni i alarmit është jashtë funksionit.

Furnizimi me dyshekë adekuate ishte një nga rekomandimet e MKP-së për UKIP-un, i cili u zbatua. MKP-ja konsideron se në repartin e UKIP-ut të Klinikës Psikiatrike duhet të bëhen rinovime sa më shpejt të jetë e mundur, në mënyrë që pacientëve t'u sigurohet akomodim në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe nacionale për akomodim të pacientëve të kësaj kategorie. MKP-ja po ashtu vëren se KPT-ja në raportin për vizitën në Kosovë, i publikuar në shtator të vitit 2021, u rekomandoi autoriteteve kompetente të ndërmarrin hapa konkretë për të evituar mangësitë e konstatuara për sa u përket kushteve të akomodimit.⁸³

Trajtimi dhe aktivitetet në repartin e UKIP-ut - Gjatë vizitës (gusht 2022), MKP-ja kontrolloi regjistrin e pranimit të rasteve në UKIP dhe nuk ka vërejtur mbipopullim asnjëherë në këtë repart, më së shumti ishin prezentë 10-12 pacientë. Gjatë kohë së vizitës nga MKP-ja, ishin prezentë katër pacientë, të cilët u intervistuan dhe ekipi i MKP-së nuk mori asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për sjellje jo të mirë të personelit.

Gjatë vizitave në këtë repart, MKP-ja ka vërejtur se trajtimi kryesor është me medikamente. Megjithatë, MKP-ja ka vërejtur se aktivitetet psiko-sociale nuk ishin të mjaftueshme.

82 Shih rekomandimet në Raportin për vizitën në Qendrën për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmureve Kronikë Psikiatrikë në Shtime, i publikuar më 26 tetor 2018. <https://oik-rks.org/2018/10/26/1-raport-me-rekomandime-i-mkpt-lidhur-me-viziten-ne-shtime/>.

83 KPT, Raporti për vizitën në Republikën e Kosovës, publikuar më 23 shtator 2021, paragrafët 124, 125 dhe 127. Shih në: https://www.coe.int/en/web/cpt/kosovo/-/asset_publisher/WsovygSd8qFK/content/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-kosovo-

MKP-ja ka vërejtur se mungon ekipi shumëdisiplinor, si: psikologu, punëtori social, terapisti okupacional dhe mungon plani individual i trajtimit. MKP-ja konsideron se autoritetet dhe institucionet duhet të sigurojnë llojshmërinë e nevojshme të profesionistëve psiko-socialë si parakusht për një trajtim adekuat të pacientëve.

MKP-ja ndër vite ka vërejtur se nuk ka evidenca që është ofruar shpjegim me shkrim për arsyet e trajtimit të pavullnetshëm, ashtu siç parashihet në nenin 21, paragrafi 1.4, të Ligjit për Shëndetin Mendor, i cili shprehimisht përcakton se pacientit të trajtuar pa vullnetin e tij/saj, ndër të tjera, duhet t'i shpjegohet me shkrim, brenda 48 orëve, arsyet e trajtimit të pavullnetshëm.

Për sa i përket së drejtës për trajtim, e njëjta situatë ishte konstatuar edhe në raportin e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, për vizitën në Kosovë në vitin 2015⁸⁴ dhe 2020⁸⁵, ku theksohej: *“Pranimi i një personi në një institucion psikiatrik mbi baza të pavullnetshme, qoftë në kontekstin e një procesi gjyqësorë civil apo penal, nuk duhet të përjashtojë marrjen e pëlqimit të informuar për trajtim. Çdo shmangie nga ky parim duhet të bazohet në ligj dhe të lidhet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe duhet të shoqërohet me masa mbrojtëse të përshtatshme.”* Në Kosovë në të shumtën e rasteve pacientëve nuk u jepet mundësia e dhënies së pëlqimit me shkrim apo e drejta për refuzim të trajtimit.

Mjetet e kufizimit në repartin UKIP - Në UKIP nuk përdoret kufizimi mekanik, por vetëm masa e izolimit dhe kufizimi kimik. Gjatë vizitës, MKP-ja ka vërejtur se dosjet e pacientëve përmbanin vlerësimin e tre mjekëve, anamnezën, historinë e sëmundjes, formularin për vendosjen në dhoma të

izolimit, kërkesën për pranim në spital, por nuk ka pëlqim për trajtim dhe nuk ka miratim të informuar.

MKP-ja konsideron se përderisa reparti përdor masën e izolimit, ky mjet kufizimi duhet të jetë subjekt i një politike të detajuar për pacientët të cilët vendosen në dhoma izolimi, e cila duhet t'i përmbajë informatat për situatat kur mund të përdoret izolimi, objektivat e synuara, kohëzgjatjen dhe nevojën për shqyrtim të rregullt të vendimit për izolim, ekzistimi i kontakteve të mirëfillta njerëzore, nevojën që personeli të jetë në mënyrë të veçantë vigjilent.

MKP-ja ka vërejtur se reparti nuk ka regjistër të veçantë për personat të cilët vendosen në izolim. Prandaj MKP-ja konstaton se ende nuk është zbatuar rekomandimi për të krijuar një regjistër të tillë, i cili iu dërgua autoriteteve kompetente përmes raportit me rekomandime, i publikuar më 26 tetor 2018.⁸⁶

Edhe KPT-ja, në raportin e fundit për vizitën në Kosovë, i publikuar në shtator 2021, ka vërejtur se izolimi i pacientëve ishte një praktikë e shpeshtë e kombinuar me administrimin me forcë të ilaçeve. KPT-ja theksoi se përdorimi i mjeteve të kufizimit duhet të jetë subjekt i një politike gjithëpërfshirëse dhe ka dërguar një numër rekomandimesh specifike në këtë drejtim.

Incidentet në Repartin UKIP - Gjatë kohës së vizitës nga MKP-ja, bazuar në evidencat dhe informatat e personelit të Repartit UKIP dhe të dokumentacionit relevant, nuk ka pasur incidente.

84 Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, i publikuar në vitin 2016, paragrafi 101. Për më shumë: <https://rm.coe.int/16806a1efc> (4.7.2018).

85 Shih Raportin e KPT-së, paragrafi 145, për vizitën e fundit në Kosovë, i publikuar më 23 shtator 2021: <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/the-cpt-publishes-report-on-kosovo>.

86 Po aty: <https://www.oik-rks.org/2018/10/29/raport-me-rekomandime-lidhur-me-viziten-ne-kliniken-psikiatrike-ne-qkuk/>.

QENDRAT E SHËNDETIT MENDOR DHE SHTËPITË INTEGRUESE NË BASHKËSI

Legjislacioni relevant për këto institucione gjendet në Ligjin nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, ku neni 10 i këtij ligji përcakton kategoritë e shërbimeve përmes të cilave ofrohet kujdesi për shëndetin mendor, siç janë: kujdesi shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor. Në shërbimet e shëndetit mendor të nivelit dytësor (pjesë e ShSKUK-së) bëjnë pjesë: departamentet e psikiatrisë, në kuadër të spitaleve të përgjithshme; Qendrat e Shëndetit Mendor dhe Shtëpitë Integruese në Bashkësi; Qendra për Integrimin, Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë në Shtime (në tekstin e mëtejme: QIRSKP).

Në Kosovë, Shërbimi komunitar dhe rezidencial ofrohet përmes Shërbimit profesional të shëndetit mendor dhe gjithsej janë nëntë (9) Qendra të Shëndetit Mendor [QShM], me nëntë (9) Shtëpi për Integrim në Bashkësi [ShIB], që ofrojnë shërbime të shëndetit mendor në të gjitha regjionet e Kosovës.

Qendrat e Shëndetit Mendor (QShM) në komunitet ofrojnë shërbime ditore, trajtim me medikamente dhe aktivitete psiko-sociale. Në QShM puna organizohet në dy mënyra: në atë të brendshme, që zhvillohen aktivitete psiko-sociale brenda në Qendër, ku u japin terapi me medikamente falas; dhe në atë që bëhet në terren nga ekipi mobil i Qendrës, ku i mbulojnë regjionet e atij qyteti ku ndodhet QShM-ja. Këto vizita të ekipit mobil bëhen me qëllim të mbështetjes psiko-sociale, dhënies së

terapisë me rregull, njëkohësisht ofrojnë mbështetje edhe për familjen.

Shtëpi Integruese në Bashkësi gjithsej janë nëntë (9), secila ka kapacitet për 10 rezidentë, përveç ShIB në Mitrovicë, e cila ka kapacitet për 20 rezidentë. Shtëpitë për Integrim në Bashkësi ofrojnë kujdes shëndetësor 24 orë në funksion të rehabilitimit dhe riintegrimin social të klientëve me sëmundje dhe me çrregullime kronike psikotike në remision. Në ShIB nuk pranohen rastet me prapambetje mendore, as me demencat e të gjitha llojeve, as me sëmundjet e vartësisë dhe as rastet sociale.

Vendosja e rezidentëve në Shtëpitë Integruese në Bashkësi është bazuar në kriteret e përcaktuara në *Udhëzimin Administrativ nr.07/2009 (në Shëndetësi) për shërbimet profesionale të shëndetit mendorë në Republikën e Kosovës*, i cili UA është shfuqizuar me Vendim të QRK, Nr. 02/50, datë 23.12.2021.

Gjatë vitit 2022, MKP ka vizituar Qendrën e Shëndetit Mendorë në Prishtinë dhe Shtëpinë Integruese në Bashkësi në Bresje dhe Shtëpinë Integruese në Ferizaj.

Trajtimi i rezidentëve në ShIB Bresje dhe në ShIB Ferizaj – MKP-ja ka intervistuar rezidentët pa prezencën e stafit të shtëpive dhe nuk ka marrë ankesa për keqtrajtim fizik. Ekipi ka vërejtur një atmosferë relaksuese mes rezidentëve dhe stafit

shëndetësor. Për sa u përket incidenteve, gjatë kohës së vizitave, ekipi i MKP-së nuk kanë vërejtur ndonjë incident të evidentuar në fletoren e raportit ditor të stafit. Sipas informatave të stafit, ka ndodhur të kishte ndonjë fjalosje mes rezidentëve, por rastet e tilla janë menaxhuar mirë.

Kushtet e akomodimit në SHB-të e vizituara – Shtëpitë Integruese në Bashkësi në Bresje në dhe Ferizaj i plotësojnë të gjitha kushtet e nevojshme për jetesë. Sipas njoftimit të ushtruesit të detyrës së drejtorit të Qendrës së Shëndetit Mendor në Prishtinë, Shtëpia në Bresje është rinovuar komplet në tremujorin e katërt të vitit 2022. Sipas informatave të stafit të shtëpive, furnizimet ishin të kënaqshme me ushqime dhe nuk raportuan probleme me ngrohje e as me veshmbathje.

Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë në Shtime (QIRSKP)

QIRSKP-ja funksionon në kuadër të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) dhe ofron shërbime 24 orë në ditë. QIRSKP-ja është institucion i tipit të hapur, rezidentët në këtë qendër janë kryesisht të diagnostikuar me çrregullime psikotike, si schizofrenia. Kapaciteti zyrtar për akomodim në këtë institucion është për 60 rezidentë dhe gjatë kohës së vizitës nuk u vërejt mbipopullim, gjithsej ishin prezentë 60 rezidentë.

Bashkëpunimi me MKP-në dhe trajtimi i rezidentëve - Gjatë vizitës që ekipi i MKP-së (21 prill 2022) i bëri QIRSKP-së, ky ekip hasi në bashkëpunim të plotë me stafin shëndetësor ku kishte qasje të papenguar në çdo hapësirë dhe iu mundësua realizimi i intervistave me rezidentë pa prezencë të stafit shëndetësor. MKP-ja ka vërejtur se rezidentët trajtohen në mënyrë humane dhe ka

komunikim dhe klimë pozitive ndërmjet rezidentëve dhe personelit.

Gjatë dy viteve të fundit, ekipi shumëdisiplinor (si: psikiatri, psikologu, punëtori social, infermieri) ka përpiluar Planin Individual të Trajtimin për disa raste, ku sipas tyre, rreth 23 rezidentë janë më aktivë dhe të gatshëm për bashkëpunim dhe për këtë arsye nuk kanë të gjithë rezidentët Plan Individual të Trajtimin.

Për sa u përket kushteve të akomodimit - MKP-ja ka vërejtur se në QIRSKP janë katër reparte psikiatrike [A1, A2, A3 dhe A4] me nga 15 shtretër. Dhomat ku akomodohen rezidentët janë të stolisura me fotografi të aktiviteteve të realizuara nga vetë rezidentët, të cilat ofrojnë stimulim të duhur pamor dhe ndikon mirë tek rezidentët në kuptim terapeutik. QIRSKP-ja ka dhomat e veçanta ku trajtohen pacientët psikiatrikë, të cilët kanë ndonjë sëmundje transmissive (TBC, apo ndonjë sëmundje specifike transmissive, e cila përhapet përmes organeve të frymëmarrjes). QIRSKP-ja ende nuk e ka Njësinë Rehabilituese-Vokacionale (me hapësirë rehabilituese rekreative për aktivitete psikosociale ditore), por aktivitetet i realizojnë në hapësira të qëndrimit ditor. Në përgjithësi, MKP-ja konsideron se kushtet e akomodimit në këtë institucion janë të një standardi të lartë.

Lidhur me incidentet dhe mjetet e kufizimit - MKP-ja ka vërejtur se deri në kohën e vizitës nga MKP-ja (prill 2022), ekipi evidentoi 1 incident ku janë lënduar rezidentët me njëri-tjetrin dhe lëndimet janë evidentuar në regjistra të veçantë. QIRSKP-ja nuk posedon dhoma të izolimit, nuk përdor kufizim mekanik, mirëpo kur stafi vëren shqetësime apo sjellje agresive, psikiatri, që njëkohësisht është edhe drejtor i institucionit, aplikon kufizim kimik për ato raste. Gjatë kohës së vizitës nga MKP-ja, në Protokollin "Vizitat Psikiatrike", ekipi evidentoi disa raste ku psikiatri ka përdorur kufizim kimik, për shkak të shqetësimeve që i ka vërejtur tek ato raste. Ndërsa përshtkrimi i rasteve të shqetësuar,

në detaje ishte i shënuar tek regjistri i kujdestarive që e mbanin infermierët si dhe te dosjet individuale të secilit rast ku është përdorur kufizimi kimik, më datë dhe me nënshkrim të psikiatrit.

Stafi në QIRSKP- gjithsej janë 42, duke përfshirë infermierë, ndihmës mjekësorë, kuzhinierë, ndihmës kuzhinierë, staf teknik. Nga 2 infermierë mbajnë kujdestarinë në orare 12 orësh në katër ndërrime, gjithashtu edhe 3 janë staf i sigurimit. Sipas drejtorit, ka mungesë të fizioterapeutit dhe të zyrtarëve administrativë.

Si sfidë, e përmendur nga drejtori i QIRSKP-së, është referimi nga gjykata i rasteve për trajtim të detyrueshëm psikiatrik si dhe heqja e zotësisë së veprimit të përhershëm të disa pacientëve. MKP-ja do të trajtojë me kujdes këto tema gjatë vitit në vazhdim.

INSTITUCIONET E KUJDESIT SOCIAL

Instituti Special në Shtime (ISSh), Shtëpia e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore në Shtime, Shtëpitë me Bazë në Komunitet (ShBK)

Trajtimi për personat me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor ofrohet gjatë 24 orëve në Institutin Special në Shtime dhe në nëntë [9] Shtëpi me Bazë në Komunitet.

Instituti Special në Shtime dhe Shtëpia e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta në Shtime, deri në fund të vitit 2022 janë menaxhuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (në tekstin e mëtejme: MFPT), ndërsa pritet që nga janari 2023 këto institucione të kalojnë nën menaxhim të Ministrisë së Shëndetësisë. Ndërsa Shtëpitë me Bazë në Komunitet, nga janari i vitit 2016, menaxhohen nga drejtoritë komunale për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.

Legjislacioni relevant - Instituti Special në Shtime dhe Shtëpitë me Bazë në Komunitet rregullohen në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.11/2014 për Punën dhe Vendosjen e Rezidentëve, Personave me Aftësi të Kufizuara Mendore-Ngecje në Zhvillimin Mendor, në Institutin Special në Shtime dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet. Në këtë UA parashihet trajtimi i personave që u është marrë zotësia e veprimit nga Gjykatat Themelore. Gjatë vizitave, MKP-ja u njoftua se të gjitha rasteve të

vendosura në këto institucione u është hequr zotësia e veprimit dhe u është përcaktuar kujdestari ligjor.

Neni 18, paragrafi 1, i Ligjit nr.0/5L-025 për Shëndetin Mendor, thekson: “Personave, që gjenden në institucionet rezidenciale të përkujdesit social, u ofrohet këshillim, trajtim, rehabilitim dhe kujdes në shëndet mendor në mënyrë të barabartë dhe sipas standardeve shëndetësore, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.” Paragrafi 2 i këtij neni thekson: Mënyra e organizimit dhe e dhënies së shërbimeve, të parashikuara në paragrafin 1, të këtij neni, përcaktohet me akt të veçantë nënligjor të propozuar nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të miratuar nga Qeveria.”

MKP-ja, në Raportin me rekomandime për vizitën në Institutin Special në Shtime, publikuar më 22 shkurt 2021,⁸⁷ u ka rekomanduar autoriteteve kompetente që të nxirren aktet nënligjore në pajtim me nenin 18 të Ligjit për Shëndetin Mendor, mirëpo ky rekomandim ende nuk është implementuar.

Vizita në Institutin Special në Shtime (ISSh)

MKP-ja gjatë vitit 2022 ka realizuar dy (2) vizita në ISSh, me të cilën ka pasur bashkëpunim shumë të mirë. Ekipit iu ka lejuar qasja në çdo hapësirë dhe iu ka mundësuar intervista me disa pacientë të cilët ishin në gjendje të komunikojnë.

87 Më gjerësisht shih në: <https://oik-rks.org/2018/01/31/raport-i-mkpt-instituti-special-ne-shtime/>

Instituti Special në Shtime është institucion i tipit të hapur, i cili ofron shërbime 24 orësh, si: ushqim, veshmbathje, përkujdesje shëndetësore, terapi të punës edukative dhe aftësuese, trajtim social. Kapaciteti zyrtar i institucionit është për 63 shtretër dhe gjatë vizitës është konstatuar se janë të vendosur 63 rezidentë. Kategorizimi i rezidentëve është bërë sipas gjinisë dhe gjendjes shëndetësore.

Kushtet e banimit - Kushtet e banimit në përgjithësi janë shumë të mira, hapësirat e banimit kanë ndriçim natyral të mjaftueshëm, ngrohje, ajrim si dhe pastërtia është në nivel të kënaqshëm. Dhomat ku akomodoheshin rezidentët, kryesisht janë me nga 2 deri 3 shtretër në një dhomë, ka komodina për vendosjen e rrobave dhe gjërave personale, gjithashtu ka edhe stolisje për stimulim pamor, p.sh. piktura të ndryshme, të cilat janë punuar nga disa rezidentë në bashkëpunim me instruktorët. Gjatë vizitës në ISSh, ekipi i MKP-së ka vizituar edhe kuzhinën, ku përgatitet dhe shërbehet ushqimi. Kuzhina kishte ndriçim dhe ventilim të duhur, pastërtia ishte në nivel, si dhe ushqimi ishte adekuat.

Trajtimi, stafi dhe aktivitetet në ISSh - Gjatë vizitës nga MKP-ja, vërehej një qasje e afërt e stafit ndaj rezidentëve. Rezidentët dukeshin mirë për nga veshja dhe higjiena, raporti me stafin ishte miqësor. MKP-ja nuk ka hasur në rezidentë me shenja të lëndimeve.

Për sa i përket stafit, gjithsej janë shtatëdhjetë (70) punëtorë. ISSh-i gjatë vitit 2022 i kishte implementuar të gjitha rekomandimet e Avokatit të Popullit për sa i përket stafit dhe ambulancës ku qëndron stafi shëndetësor. Tani kishte punësuar mjekun e përgjithshëm dhe psikiatrin me gjysmë orari, një psikolog, një teknik të fizioterapisë, dy infermierë, një ergoterapeut dhe një ndihmës mjekësor. Ambulanca ku qëndronte personeli

shëndetësor dhe ku ofroheshin disa shërbime shëndetësore, tani i plotëson kushtet, pasi është ndarë në hapësirë të veçantë. Ky ishte rekomandim edhe në Raportin me rekomandime për vizitën në Institutin Special në Shtime, publikuar më 22 shkurt 20217.⁸⁸

Shërbimet stomatologjike merren nga Shtëpia për të Moshuar në Prishtinë. Në rast nevojë, shërbimet e tjera shëndetësore dhe specialistike rezidentëve u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Shtime, nga Spitali Rajonal në Ferizaj dhe nga Qendra Klinike Universitare në Prishtinë.

Aktivitetet psiko-sociale janë të ndryshme, janë tri dhoma të terapisë së punës: Punëtorja e artit, zdrukthëtarisë dhe e punëdores. Në to përfshihen të gjithë personat që janë të aftë për këto aktivitete. Po ashtu ekziston edhe salla e aktiviteteve të tjera rekreative-sportive (pingpong, shah, domino, letra etj.). Si aktivitete të tjera janë kampingu në natyrë, lojëra të ndryshme dhe shëtitjet në qytete të ndryshme, me grupe të vogla, si dhe daljet në lokale në qytezën e Shtimes.

Për sa i përket mjeteve të kufizimit - Sipas drejtorit, në ISSh nuk ka dhoma të izolimit dhe nuk përdoren forma të kufizimit fizik.

Vizita në Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore në Shtime

MKP-ja më 14 prill 2022 ka realizuar vizitë përcjellëse në Shtëpinë e Fëmijëve në Shtime. Ky institucion është i vetmi institucion i tipit të hapur me kapacitet prej 10 shtretërish dhe i cili akomodon fëmijët me nevoja të veçanta (paaftësi në mësim-prapambetje mendore). Shtëpia e Fëmijëve ofron shërbime 24 orësh, si në vijim: ushqim,

88 Më gjerësisht shih në: <https://oik-rks.org/2018/01/31/raport-i-mkpt-instituti-special-ne-shtime/>

veshmbathje, përkujdesje shëndetësore, terapi të punës edukative dhe aftësuese, trajtim social.

Gjatë vizitës së fundit, MKP-ja ka vërejtur se në këtë institucion janë të vendosur 10 persona të moshave të ndryshme, ku vetëm një rezidente është nën moshën 18 vjeçe, të tjerët e kanë arritur moshën madhore.

Bazuar në faktin se ky institucion është përcaktuar si Shtëpi e Fëmijëve, është e papranueshme që të vazhdojë qëndrimi në shtëpi i banorëve të rritur. Avokati i Popullit është informuar se ka raste të fëmijëve me nevoja të veçanta që janë në pritje për akomodim në këtë Shtëpi, mirëpo sipas njoftimit të udhëheqëses së Shtëpisë, nuk ka vende të lira në asnjë Shtëpi me Bazë në Komunitet për akomodim të rezidentëve që kanë arritur moshën madhore. Gjatë vitit 2023, MKP-ja e Avokatit të Popullit do të vazhdojë të diskutojë me autoritetet kompetente lidhur me këtë çështje.

Trajtimi dhe aktivitetet në Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore - Gjatë vizitës, MKP-ja ka vërejtur një qasje të afërt, të ngrohtë e miqësore nga ana e stafit ndaj rezidentëve. MKP-ja nuk ka rastisur në persona me shenja të lëndimeve.

Për sa u përket aktiviteteve psiko-sociale, MKP-ja u njoftua se banorët zakonisht dëgjojnë muzikë si dhe dalin jashtë në natyrë, bëjnë disa dalje në qytet, ndonëse të rralla. Ndërsa disa nga rezidentët vijnë në mësimin në shkollë speciale. MKP-ja konstaton se numri dhe cilësia e aktiviteteve psiko-sociale është e varfër dhe nuk ka një plan të individualizuar të trajtimit sipas nevojave dhe aftësive të rezidentëve.

Kushtet e akomodimit në Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore - në përgjithësi janë të mira, dhomat e rezidentëve kanë hapësirë të mjaftueshme dhe nuk janë të mbipopulluara, viteve të fundit ka pasur renovime në tërë hapësirat e Shtëpisë. Sipas menaxheres së Shtëpisë, KFOR-i turk ka shprehur gatishmërinë që t'i pajisë me

mjete të fizioterapisë, mirëpo Shtëpisë i mungon hapësira për fizioterapi.

Shërbimet shëndetësore në Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore - Shërbimi shëndetësor dhe psikiatrik është i përbashkët me Institutin Special në Shtime. Psikiatri i viziton një herë në javë, rastet ndonjëherë dërgohen edhe në ambulancën e Institutit Special në Shtime. Në rast nevoje, shërbimet e tjera shëndetësore dhe specialistike u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Shtime dhe Qendra Klinike Universitare në Prishtinë. Analizat laboratorike u bëhen në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Shtime çdo 6 muaj në mënyrë të rregullt, të cilat edhe MKP-ja i ka verifikuar gjatë vizitës së fundit.

Për sa i përket stafit, gjithsej janë tetë persona (katër ndihmës mjekësorë, katër infermierë) si dhe menaxheri i Shtëpisë.

Lidhur me furnizimet me veshmbathje, shtrojëmbulujë, institucioni ka pranuar donacion nga KFOR-i turk dhe nga një kompani private dhe në këtë drejtim nuk ka probleme të theksuara. Po ashtu, për sa i përket furnizimit me ushqim dhe me barna, gjendja për momentin është e mirë.

Mjetet e kufizimit - Në Shtëpinë e Fëmijëve nuk ka dhoma të izolimit dhe nuk përdoren forma të kufizimit mekanik. Në disa raste të caktuara përdoret kufizimi kimik i përshkruar nga psikiatri.

Shtëpitë me Bazë në Komunitet (ShBK)

Gjithsej janë 10 Shtëpi me Bazë në Komunitet, në komunat: Kamenicë, Deçan, Ferizaj, Vushtrri, Lipjan, Graçanicë, Shtime dhe Prizren si dhe Shtëpia e Fëmijëve në Shtime. Secila Shtëpi ka kapacitet për 10 rezidentë, përveç ShBK-së në Shtime, me kapacitet 12 shtretër.

Gjatë vitit 2022, MKP-ja ka vizituar Shtëpitë me Bazë në Komunitet në Shtime, në Ferizaj dhe në Prizren.

Trajtimi i rezidentëve në ShBK në Shtime, në Ferizaj dhe në Prizren – MKP-ja ka intervistuar rezidentët, pa prezencën e stafit të shtëpive, dhe nuk ka pranuar ankesa për keqtrajtim fizik. Për sa u përket incidenteve, gjatë kohës së vizitave ekipi i MKP-së nuk ka vërejtur ndonjë incident të evidentuar në fletoren e raportit ditor të stafit të këtyre shtëpive. Sipas informatave të stafit, ka ndodhur të kishte ndonjë fjalosje mes rezidentëve, por rastet e tilla janë menaxhuar mirë.

Kushtet e akomodimit në ShBK-të në Shtime, në Ferizaj dhe në Prizren – Për sa u përket kushteve të akomodimit, Shtëpitë me Bazë në Komunitet në Shtime, në Ferizaj dhe në Prizren në përgjithësi i plotësojnë të gjitha kushtet e nevojshme për jetesë, përveç në Prizren, ku ekipi i MKP-së ka vërejtur mangësi.

Më 8 nëntor 2022, MKP-ja e vizitoi Shtëpinë Rezidenciale për persona me aftësi të kufizuara mendore në Prizren, e cila, sipas informacioneve, është funksionalizuar para dy vjetësh. Gjatë vizitës, ekipi i MKP-së ka vërejtur disa mangësi në funksionimin e kësaj qendre, e të cilat mund të afektojnë në respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara mendore në këtë institucion. Disa nga gjetjet që mund të përmendim, janë: ngrohja e objektit funksionon me pelet dhe ekipi ka gjetur se institucioni nuk ka pelet në këto ditë të ftohta dimri; gjashtë muaj nuk është zhvilluar asnjë procedurë prokurimi për furnizim me ushqim dhe furnizimi me gjëra ushqimore, ka funksionuar nëpërmjet ndihmave të donatorëve dhe vetë pensioneve të rezidentëve; veshmbathjet sigurohen po ashtu nëpërmjet ndihmave; nuk kishte barna të mjaftueshme ngase tani janë duke u shfrytëzuar rezervat e fundit; Shtëpia nuk ka udhëheqës.

Stafi i përzgjedhur është i pakualifikuar dhe pa përvojë në fushën e shëndetit mendor, e për me keq, që nga hapja e shtëpisë nuk është organizuar asnjë trajnim lidhur me punën që duhet të bëhet me këtë kategori të personave; disa nga personeli nuk kanë as kontrata pune.

Lidhur me këto gjetje, Avokati i Popullit ka hapur rast *Ex-officio*,⁸⁹ dhe më 30 nëntor 2022 i ka dërguar shkresë zyrtare Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prizren, në mënyrë që ta informojnë Avokatin e Popullit nëse janë të njoftuar për gjendjen e Shtëpisë Rezidenciale në Prizren dhe për veprimet që janë ndërmarrë apo që planifikojnë t'i ndërmarrin për këto çështje. Avokati i Popullit, përmes postës elektronike, ka marrë përgjigjen jashtë afatit ligjor. Në këtë përgjigje është potencuar që vërejtjet e Avokatit të Popullit qëndrojnë dhe se i kanë ndërmarrë veprime lidhur me rregullimin e gjendjes. MKP-ja lidhur me këtë çështje do të vazhdojë me vizita përcjellëse në terren.

Për sa u përket furnizimeve me veshmbathje, barna si dhe ngrohjes, ekipi i MKP-së nuk ka vërejtur mangësi në Shtëpitë me Bazë në Komunitet në Ferizaj dhe as në Shtime.

Incidentet në ShBK-të e vizituara - Bazuar në dokumentacionin e analizuar dhe njoftimet nga udhëheqësit e Shtëpive në Shtime, në Ferizaj dhe në Prizren nuk u vërejtën raste të incidenteve ndërmjet rezidentëve, apo incidente me stafin.

Shërbimet shëndetësore të ShBK-ve të vizituara - realizohen në qendrat e mjekësisë familjare të komunave përkatëse, ndërsa për sa u përket shërbimeve psikiatrike, ShBK-ja në Ferizaj dhe ajo në Prizren i realizojnë në Qendrat e Shëndetit Mendor të komunave përkatëse. ShBK-ja në Shtime shërbimet specialistike i realizon në Ferizaj dhe në

89 Nr. i rastit 662/2022.

Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). MKP-ja ka vërejtur se analizat laboratorike u bëhen me rregull rezidentëve në këto Shtëpi.

Mjetet e kufizimit në ShBK-të e vizituara – Në Shtëpitë me Bazë në Komunitet nuk kanë dhoma të izolimit dhe nuk përdoren forma të kufizimit fizik, përveç në një rast në ShBK-në në Shtime, ku një rezident shpesh e lëndon veten dhe ndodh që ia lidhin duart nga mbrapa me një lidhëse, lirshëm, sa për të mos ia lejuar vetëlëndimin. Stafi ka shprehur keqardhje për menaxhimin e këtij rasti në këtë mënyrë, megjithatë, sipas pohimeve të personelit, ata kanë provuar të gjitha format e mundshme për ta menaxhuar këtë rast pa përdorur mjetet e kufizimit, por pa sukses.

MKP-ja konsideron se menaxheri i Shtëpisë, me rekomandim të psikiatrit, duhet ta adresojnë këtë rast në institucione të tjera të specializuara psikiatrike (Klinika e Psikiatrisë etj.) për të gjetur mënyra dhe qasje të trajtimit sa më të përshtatshme dhe me dinjitet duke krijuar një komision të jashtëm vlerësues. Zakonisht rasteve agresive psikiatri u përshkruan kufizim kimik, që i evidentojnë në dosjet e rasteve.

Institucionet e Shëndetit Mendor të vizituara gjatë vitit 2022

Institucioni i vizituar	Nr. i vizitave
1. Instituti i Psikiatrisë Forenzike	3
2. Klinika Psikiatrike – Reparti i Urgjencës dhe të Kujdesit Intensiv Psikiatrik i Klinikës Psikiatrike (tani e tutje: UKIP)	2
3. Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë në Shtime (QIRSKP)	1
4. Instituti Special në Shtime (ISSh)	2
5. Shtëpia e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore në Shtime	1
6. Shtëpia me Bazë në Komunitet në Shtime	1
7. Shtëpia me Bazë në Komunitet (ShBK) në Ferizaj	2
8. Shtëpia Integruese në Bashkësi në Ferizaj	1
9. Shtëpia rezidenciale ose me Bazë në Komunitet në Prizren	1
10. Shtëpia Integruese në Bashkësi (ShIB) në Bresje	1

KAPITULLI VI

VI. SHËPITË PËR PERSONAT E MOSHUAR DHE PA PËRKUJDESJE FAMILJARE

Gjatë vitit 2022, MKP-ja, në bazë të mandatit e saj, ka vizituar Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë (ShPMPF), Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Gurrakoc, Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Skenderaj, Institutin Special në Shtime dhe Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore në Shtime.

Qëllimi i vizitave ishte vlerësimi i gjendjes së institucioneve në fjalë, menaxhimi i situatave në institucion, kushtet e akomodimit, sfidat me të cilat përballen këto institucione, si dhe progresi i autoriteteve kompetente në implementimin e rekomandimeve të IAP-së, të dërguara përmes raporteve të mëhershme me rekomandime.

Shtëpia për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (ShPMPF) në Prishtinë, është institucion me karakter social dhe vepron në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Kapaciteti zyrtar i këtij institucioni është për 100 persona. Gjatë vizitës, në ShPMPF në Prishtinë ishin të akomoduar 63 rezidentë.

Kurse Shtëpitë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Gurrakoc dhe ajo në Skenderaj veprojnë në kuadër të komunave përkatëse. Kapaciteti i këtyre shtëpive është për 20 persona.

Trajtimi - Gjatë vizitave në këto institucione, MKP-ja ka intervistuar një numër të rezidentëve dhe nuk ka marrë asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për abuzime verbale, si dhe as për sjellje të cilat do ta shkelnin dinjitetin njerëzor të rezidentëve në ShPMPF. MKP-ja çmon lart angazhimin e personelit për kujdesin ndaj të moshuarve, sidomos ndaj të moshuarve të palëvizshëm.

Incidentet ndërmjet rezidentëve - MKP-ja u njoftua se gjatë këtij viti nuk janë shënuar raste të dhunës ndërmjet rezidentëve, përpos ndonjë fjalosjeje. Këto pohime u verifikuan edhe përmes kontrollit të dokumentacionit relevant, si dhe përmes intervistimit të banorëve në ShPMPF në Prishtinë, në Skenderaj dhe në Gurrakoc.

Kushtet e akomodimit - MKP-ja gjatë vizitës në **Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (ShPMPF) në Prishtinë** është njoftuar se ka pasur renovime në ambientin e jashtëm, por nuk janë përfunduar për shkak të shkëputjes së kontratës nga nënkontraktori. MKP-ja ka vërejtur se ekziston një ashensor që është funksional, por është shumë i vjetër dhe shpesh pëson defekte, si dhe hapësira është e pamjaftueshme për rezidentët që lëvizin me karroca. Ndërtimi i një ashensori të ri kishte filluar, por punimet ishin ndërprerë për shkak se nënkontraktori e kishte ndërprerë kontratën.

MKP-ja gjatë vizitës në ShPMPF në Prishtinë ka marrë ankesë nga rezidenti G. S., i cili është me

aftësi të kufizuara në karrocë dhe i cili pohoi se që tri vjet nuk ka pasur qasje në oborr, për shkak të hapësirës së vogël të ashensorit. Lidhur me këtë ankesë, MKP-ja sërish ka kërkuar nga organet kompetente që gjendja e krijuar të përmirësohet sa me shpejt, duke i bërë aranzhimet e nevojshme në mënyrë që rezidenti ta gëzojë të drejtën e vet, në mënyrë të barabartë me banorët e tjerë dhe pa asnjë diskriminim.⁹⁰ Po ashtu, MKP-ja ka vërejtur se dhomat ku vendosen rezidentët kanë ndriçim të mjaftueshëm, në përgjithësi nuk kanë lagështi, por inventari është i vjetruar dhe i dëmtuar në disa dhoma, si dhe banjat janë shumë të dëmtuara.

Në bazë të të gjeturave të MKP-së për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë, Avokati i Popullit, në Raportin me rekomandime⁹¹ i është drejtuar Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me rekomandime konkrete për të cilat ende nuk ka marrë përgjigje.

Për sa u përket kushteve të akomodimit në **Shtëpinë për Persona të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Gurrakovc**, MKP-ja ka vërejtur se nëpër dhoma ishin të vendosur nga dy të moshuar, dhomat ishin të mëdha dhe me ndriçim, posedonin shtretër të mirë që janë sjellë si donacion. Kuzhina ishte rinovuar dhe pajisur me të gjitha elementet e reja, janë vendosur pllakat e reja, dollapët e rinj, 3 frigoriferë, lifti për bartjen e ushqimit është funksional.

Lidhur me infrastrukturën në **Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Skenderaj**, MKP-ja gjatë vizitës ka vërejtur se në dhoma qëndrojnë nga dy të moshuar, por kishte edhe prej atyre, sidomos kategoria e varurve,

që qëndronin nga tre, kryesisht dhomat ishin të mëdha dhe me ndriçim, kishin shtretër të mirë, mbulesa dhe dollapët personalë. Komuna ka investuar vitin e kaluar dhe ka ndërtuar një objekt të ri, ku ka kaluar administrata, si dhe një sallë për fizioterapi, mirëpo akoma nuk është pajisur me mjete. Institucioni ka autoambulancën për shërbime mjekësore dhe furgonin për organizimin e shëtitjeve, por ka mungesë të vozitësit. Gjithashtu vlen të ceket edhe mosfunksionimi i ashensorit të kuzhinës që shërben për bartjen e ushqimit, si dhe prishja e shpeshtë e ashensorit që shërben për lëvizjen e rezidentëve për dalje jashtë objektit. Qasja që shërben për daljen e rezidentëve në oborr e të cilët janë me aftësi të kufizuara (karroca), është mjaft e papërshtatshme. Ka mungesë të kamerave, ku, sipas kryeinfermieres, janë shumë të nevojshme për sigurinë e rezidentëve. Banjat dhe tualetet ishin të përbashkëta dhe ishin mjaft të dëmtuara, po ashtu edhe dyshemeja ishte shumë e dëmtuar. Vlen të ceket se para pandemisë, janë furnizuar me 20 shtretër të rinj, si donacion nga Zvicra.

Aktivitetet psiko-sociale - Në kuadër të Shtëpisë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (ShPMPF) në Prishtinë funksionon klubi i të moshuarve, organizohen 3 shëtitje gjatë vitit, si dhe terapi për rezidentët. Programi i punës hartohet nga shërbimi social dhe terapia e punës në pajtueshmëri me shërbimin shëndetësor, duke ua përshtatur aftësive të çdo shfrytëzuesi që angazhohet në punë.⁹² Çdo kat i institucionit posedon sallat e pajisura me TV, ku të moshuarit aty e kalojnë kohën e lirë. Gjithashtu institucioni posedon edhe sallën e aktiviteteve ku zakonisht të moshuarat punojnë punë dore. Klubi i rezidentëve posedon edhe një hapësirë për lojëra me shah,

90 MKP, Raport me rekomandime për vizitën në ShPMPF, publikuar me 18 nëntor 2022. Shih në: <https://oik-rks.org/2022/11/24/raporti-mkpt-se-per-viziten-ne-shtepine-per-personat-e-moshuar-dhe-pa-perkujdesje-familjare-ne-prishtine/>

91 Shih Raportin me rekomandime për vizitën në Shtëpinë për të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë: <https://oik-rks.org/2022/11/24/raporti-mkpt-se-per-viziten-ne-shtepine-per-personat-e-moshuar-dhe-pa-perkujdesje-familjare-ne-prishtine/>

92 Neni 11, paragrafi 2, i Rregullores nr. 09/2008 mbi Organizimin e Brendshëm të Punës për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare.

domino dhe letra, ku rezidentët kanë mundësi të luajnë dhe ta kalojnë kohën e lirë.

MKP-ja, gjatë vizitës në Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Gurrakoc dhe në Skenderaj, ka vërejtur se në dispozicion të personave të moshuar në këto shtëpi janë shahu, domino, qëndrimi në oborr, si dhe mbajnë ligjërata për diabet. Shpeshherë organizojnë shëtitje jashtë Gurrakocit dhe Skenderajt, si p.sh. në Rugovë, në Istog, në Prizren. Për sa u përket vizitave, disa nga rezidentët i vizitojnë familjarët, ndonjëherë shkojnë edhe në familje.

Kontakti me botën e jashtme - Neni 16, paragrafi 1, i Rregullores nr.09/2008 mbi organizimin e brendshëm të punës për ShPMPF-në përcakton se shfrytëzuesit mund të mungojnë në ShPMPF me kërkesë të të afërmeve, mirëpo me leje të lëshuar nga nëpunësi i shërbimeve sociale në konsultim me mjekun, nëse rezidenti ka probleme shëndetësore, në periudhën kohore deri në 30 ditë të kohëpaskohshme. Ndërsa, bazuar në nenin 42, rezidentët njoftohen për kohën e përcaktuar të vizitave nga jashtë, të cilat caktohen nga shërbimi social në marrëveshje me shërbimin shëndetësor dhe orari vendoset në tabelën e shpalljeve të ShPMPF-së. Vizitat e shfrytëzuesve mund t'i ndërpresë vetëm drejtori i ShPMPF-së dhe atë në kohë të caktuar në rast të ndonjë epidemie apo të ndonjë rrezikshmërie tjetër për shfrytëzuesit.

Lidhur me këtë të drejtë, MKP-ja është njoftuar nga mediat se një rezident ka pranuar nga jashtë një vizitore gjatë ditës së diel, e cila ka refuzuar të identifikohet tek punëtorët e sigurimit, por edhe tek punëtorët e shërbimit shëndetësor. Pas kësaj, ka pasuar ankesa e punëtorëve shëndetësorë tek udhëheqësit e qendrës, të cilët menjëherë kanë ndërmarrë masa duke nxjerrë një vendim, të cilin e kanë vendosur në hyrje të qendrës dhe me të cilin

kanë njoftuar: *“Njoftim që vizitat për rezidentët e ShPMPF-së, të bëhen nga ora 08.00h deri në orën 16.00h gjatë ditëve të punës, në mënyrë që të jenë në përcjellje të shërbimit social dhe të evidentohet çdo vizitorë edhe tek sigurimi, për arsye se po ka raste të vizitorëve të cilët nuk lajmërohen tek punëtorët e sigurimit duke penguar punëtorët e ndërrimit të pasdites.”*

Pas këtij njoftimi, Avokati i Popullit ka realizuar vizitë në ShPMPF në Prishtinë dhe është informuar se ky vendim është nxjerrë bazuar në nenin 43 të Rregullores 09/2008, i cili përcakton: *“Vizitori nuk mund të hyjë në objekt, përderisa nuk lajmërohet tek punëtori i sigurimi të ShPMPF-së.”* Ndërsa paragrafi 2 po ashtu përcakton: *“Vizitori është i obliguar që të ofrojë dokumentin e identifikimit tek personi zyrtar dhe të lejojë kontrollimin e gjësendeve që i dërgon shfrytëzuesit.”*⁹³ Andaj edhe vendimi që është nxjerrë bazuar në rregullore ka pasur për qëllim ruajtjen e dinjitetit të rezidentëve, mirëqenien dhe sigurinë e tyre, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e institucionit dhe kategorinë shumë të ndjeshme të rezidentëve në atë institucion.

Kujdesi shëndetësor - Kujdesi shëndetësor në **Shtëpisë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (ShPMPF) në Prishtinë** bëhet sipas nevojave individuale dhe të atyre të përgjithshme. Vizitat sistematike bëhen së paku një herë në 6 muaj. Shërbimi mjekësor posedon protokolle të veçanta për vetëlëndime, për lëndime trupore, për grevë urie, për abuzime seksuale, për vetëvrasje, si dhe për vdekjet në institucion. MKP-ja ka vërejtur se janë të furnizuar mjaftueshëm me barna dhe se terapia shpërndahet me rregull nga infermierët. MKP-ja u njoftua se gjatë këtij viti në këtë institucion nuk ka ndërruar jetë asnjë rezident, kurse gjatë vitit paraparak 2021 kanë ndërruar jetë 2 rezidentë. Nga numri i përgjithshëm i rezidentëve (63), janë identifikuar 42 rezidentë me terapi

93 Neni 43, paragrafët 1 dhe 2, i Rregullores nr. 09/2008 mbi Organizimin e Brendshëm të Punës për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare.

psikiatrike, 21 rezidentë që kanë nevojë për asistencë të vazhdueshme edhe për nevoja personale, nga ky numër 13 janë plotësisht të varur dhe 12 pjesërisht të varur. Të gjithë rezidentët janë të vaksinuar me dy vaksina.

Kujdesi mjekësor në **Shtëpinë për Persona të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Gurrakoc** ofrohet nga mjeku i përgjithshëm, i cili vjen prej QKUK-së dhe i viziton 1 herë në javë. Vizitat tek internisti apo te ndonjë specialist tjetër me udhëzim të mjekut të përgjithshëm i realizojnë në Qendrën e Mjekësisë Familjare apo në Spitalin regional. MKP-ja gjatë vizitës ka vërejtur se u mungon salla për fizioterapi dhe fizioterapeuti, si dhe psikologu dhe neuropsikiatri. Për sa i përket furnizimit me barna, është i kënaqshëm.

Lidhur me kujdesin shëndetësor në **Shtëpinë për Persona të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Skenderaj**, barnatorja ekziston, por kanë mungesë të barnave, sepse në këtë vit nuk janë furnizuar fare. Në kuadër të institucionit ishte dhoma e mjekut, por aty nuk ka mjek. Shërbimet mjekësore i marrin në Qendrën e Mjekësisë Familjare, sepse kanë një bashkëpunim shumë të mirë, ku çdo të enjte një mjeke e praktikës së përgjithshme vjen dhe i kontrollon rezidentët. Te stomatologu dërgohen sipas nevojës. U vërejt mungesa e psikiatrit dhe e psikologut, ku në rast nevoje dërgohen nëpër klinika. Anti-shok terapinë e posedojnë, por i ka skaduar afati.

Procedura e parashtrimit të ankesave - Rezidentët, të cilëve gjendja shëndetësore ua mundëson këtë, mund të parashtrojnë ankesa dhe parashtrësia në departamentin përkatës të MFPT-së dhe në drejtorinë e institucionit. Rezidentët po ashtu mund t'i parashtrojnë ankesat e tyre në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP), kundër institucionit ku janë të akomoduar dhe kundër institucioneve publike të Republikës së Kosovës. Ankesat në IAP rezidentët mund t'i bëjnë përmes telefonit, postës, postës elektronike dhe duke u paraqitur personalisht në institucion. Po ashtu, institucioni kohë pas kohe vizitohet nga OJQ të ndryshme, të cilat, përveç aktiviteteve që zhvillojnë me rezidentët, pranojnë edhe ankesat e rezidentëve.

Institucionet për të moshuar	
11. Shtëpia për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë	4
12. Shtëpia për të Moshuar në Gurrakoc	1
13. Shtëpia për të Moshuar në Skenderaj	1

KAPITULLI VII

VII. AKTIVITETET DHE TAKIMET E MKP-së ME INSTITUCIONET KOMPETENTE GJATË VITIT 2022

Gjatë vitit 2022, MKP-ja, me qëllim të ngritjes së ndërgjegjësimit për përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës lidhur me mandatin e MKP-së, si dhe lidhur me modalitetet e bashkëpunimit midis MKP-së dhe institucioneve të tjera të Kosovës, ka realizuar disa aktivitete, si: takime, tryeza njëditore, konferenca, forume, përkrahur nga projekti i përbashkët i Bashkimi Evropian dhe Këshillit të Evropës, si dhe me mbështetje të projektit të IPA-European Union.

Gjatë këtij viti, MKP-ja ka vazhduar takimet e kohëpaskohshme me përfaqësuesit e Organizatës për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë (OSBE). Kështu, më 18 janar 2022 u realizua një takim në të cilin u diskutua lidhur me monitorimin e QP-Gjilan, që do ta marrë Danimarka, si dhe mbështetjen e OSBE-së për MKP-në.

Më 27 janar 2022, MKP-ja realizoi takim me përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë, në të cilin u diskutua lidhur me draftin e LESP-së, si dhe monitorimin e QP-Gjilan, që do ta e marrë Danimarka.

Më 2 shkurt 2022, MKP-ja realizoi takim me përfaqësuesit e projektit IPA, lidhur me mbështetjen e OSBE-së për MKP-në.

Më 16 shkurt 2022, MKP-ja realizoi takim me Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP), lidhur me vizitën e MKP-së në QKF-Lipjan.

Më 2 mars 2022, Avokati i Popullit dhe drejtori i MKP-së morën pjesë në Konferencën e organizuar nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), me temën: *“Marrëveshja në mes të Kosovës dhe Danimarkës për transferimin e të burgosurve në Kosovë: Implikimet në Standardet e të Drejtave të Njeriut”*. Qëllimi i Konferencës ishte diskutimi publik rreth marrëveshjes e cila do t'i mundësonte Danimarkës marrjen me qira të burgjeve në Kosovë.

Më 3 mars 2022, përfaqësuesit e MKP-së realizuan takim me Programin për të Drejtat Civile në Kosovë (CRPK).

Më 16 mars 2022, përfaqësuesja e MKP-së realizoi intervistë për KTV-në, lidhur me një mitur në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan.

Më 21 mars 2022, përfaqësuesja e MKP-së realizoi intervistë për emisionin “Gjurmët”, në RTK, lidhur me Qendrën Korrektuese për Femra (QKF) në Lipjan.

Më 30 mars 2022, përfaqësuesit e MKP-së realizuan takim me një delegacion nga FRONTEX-i.

Më 14 prill 2022, drejtori i MKP-së mori pjesë në takimin e organizuar nga Zyra e shefit të misionit të UNHCR-së. Sesioni i Planifikimit Strategjik 2023 me Palët e Interesit.

Më 14 prill 2022, Njësia Korrektuese e Misionit EULEX në Kosovë, në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë, realizoi takim me përfaqësuesin e MKP-së, lidhur me zhvillimet e fundit, gjetjet dhe rekomandimet e dërguara institucioneve kompetente.

Më 22 prill 2022, përfaqësuesit e MKP-së realizuan takim me ekspertin e Programit të Bashkimit Evropian për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë (Projekti EUKOJUST), me të cilën u diskutuan aspekte të ndryshme lidhur me situatën e të burgosurve në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan.

Më 27 prill 2022 u realizua takim me Shërbimin Sprovues të Kosovës, lidhur me shqiptimin e dënimeve dhe masave alternative.

Më 28 prill 2022, përfaqësuesit e MKP-së realizuan takim me Programin për të Drejtat Civile në Kosovë (CRPK), ku u diskutua lidhur me bashkëpunimin MKP-CRPK, për vizitat e përbashkëta në pikat kufitare dhe në Qendrat e Azilit në Magure dhe në Vranidoll.

Më 19 maj 2022, përfaqësuesit nga MKP-ja realizuan takim me zëvendësuesin e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK), lidhur me çështjet e shërbimit korrektues (Pavijoni D dhe me Marrëveshjen e Danimarkës).

Më 27 maj 2022, përfaqësuesja e MKP-së realizoi intervistë për emisionin "Kiks" në Klan Kosova, lidhur me një rezident, i cili është i vendosur në Shtëpinë për të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë.

Më 1 qershor 2022, përfaqësuesja e MKP-së mori pjesë në tryezën e organizuar nga Ministria e Drejtësisë, me temë: *"Prezantimi i Udhëzimit Administrativ për Zbatimin e Drejtësisë Mike ndaj Fëmijëve në Procedurën Penale, Civile dhe Administrative"*.

Më 13 qershor 2022, drejtori i MKP-së mori pjesë në forumin e organizuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, në mbështetje të Këshillit të Evropës dhe financuar nga Bashkimi Evropian, me temë: *"Procesi i rehabilitimit të të burgosurve ekstremist të dhunshëm dhe të radikalizuar në SHKK dhe përgatitja për riintegrimin e tyre në shoqëri"*.

Më 23 qershor 2022, anëtarët e MKP-së realizuan takim me drejtorin e Drejtorisë për Migrim, lidhur me ankesat e dy shtetasve turq.

Më 6 korrik 2022, përfaqësuesja e MKP-së mori pjesë në tryezën e organizuar nga EUKOJUST (European Union/Kosovo Justice Sector Programme, me temë: *"Access to Justice for female inmates"*.

Më 19 korrik 2022, drejtori i MKP-së dhe përfaqësuesja e MKP-së realizuan takim me ministren e Drejtësisë, ku u diskutua lidhur me çështjet e bashkëpunimit ndërinstitucional në bazë të përgjegjësisë që bien në fushëveprimin e MKP-së, në monitorimin e të drejtave të njeriut në vendet e privimit të lirisë në Kosovë.

Më 2 shtator 2022, përfaqësuesja e MKP-së mori pjesë në takimin e organizuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, lidhur me Planin e Rehabilitimit për të dënuarit.

Më 5 dhe më 6 shtator 2022, zëvendësi i Avokatit të Popullit mori pjesë në trajnimin e organizuar nga Projekti DAI Global Austria GmbH & Co KG me ekspertin e Këshillit të Evropës - në lidhje me: *"Për Përafrimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit me standardet e KEDNj-së"*.

Më 9 dhe më 10 shtator 2022, zëvendësi i Avokatit të Popullit mori pjesë në punëtorinë ndërinstitucionale mbi hartimin e legjislacionit jodiskriminues dhe trajtimin e barabartë, me ekspertin e Këshillit të Evropës, prof. Ledi Bianku.

Më 9 shtator 2022, drejtori i MKP-së mori pjesë në vazhdimin e takimit me Shërbimin Korrektues

të Kosovës, rreth Planit të Rehabilitimit për të dënuarit.

Më 20 shtator 2022, përfaqësuesja e MKP-së mori pjesë në konferencën ndërkombëtare, organizuar nga Qendra për Studime Ndërkombëtare (CeSI-Centro Studio Internazionale dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)), mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme e Italisë, përmes Ambasadës italiane në Kosovë.

Tema: *“Ndërtimi i Reziliencës: Programet R&R për Ekstremistët dhe Luftëtarët e Huaj në Kosovë dhe Itali”*.

Më 26 shtator 2022, përfaqësuesit e MKP-së realizuan takim me drejtorin e Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (DShB), lidhur me vështirësitë dhe trajtimin e të burgosurve, zbatimin e rekomandimeve dhe vështirësitë që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës.

Më 28 shtator 2022, anëtarët e MKP-së realizuan takim me drejtorin e Klinikës Psikiatrike në Prishtinë, lidhur me shërbimin psikiatrik për fëmijë dhe adoleshentë.

Më 28 shtator 2022, MKP-ja realizoi takim me drejtorin e Institutit Special në Shtime, lidhur me organizimin e aktiviteteve vjetore për shënimin e Ditës së Shëndetit Mendor.

Më 30 shtator 2022, MKP-ja realizoi takim me drejtorin e SOS-Fshatrave, për t'u informuar lidhur me trajtimin e dy fëmijëve që jetojnë në SOS Fshat, prindi i të cilëve gjendët në burg.

Më 12 tetor 2022, drejtori i MKP-së, si anëtar i Komitetit Drejtues të IPA-s, mori pjesë në takimin e rregullt ku u prezantua ecuria e projektit dhe planet për të ardhmen.

Më 24 tetor 2022 u realizua takim dhe vizitë në Institutin Special në Shtime, në vazhden e takimeve që Avokati i Popullit realizon në institucionet publike

e me qëllim të shënimit të ditëve ndërkombëtare, pasi në muajin tetor shënohet Dita Ndërkombëtare e Shëndetit Mendor (10 tetor).

Më 25 tetor 2022, zëvendësi i Avokatit të Popullit dhe përfaqësuesja nga MKP-ja morën pjesë në tryezën e organizuar nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me “Terre des homes”. Tryezë ishte për fuqizimin e bashkëpunimit mes institucioneve dhe shoqërisë civile në parandalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë.

Më 25 tetor 2022, përfaqësuesja e MKP-së mori pjesë në aktivitetin e dytë të serisë së “Dialogut për Trashëgimin e EULEX-it. Titulli i aktivitetit: *“Njësia Korrektuese e EULEX-it dhe kontributi i saj për Shërbimin Korrektues të Kosovës”*.

Më 1 nëntor 2022, përfaqësuesit e MKP-së realizuan takim me menaxherin e projektit nga Këshilli i Evropës, ku përfitues direkt janë Instituti i Psikiatrisë Forenzike, Instituti Special në Shtime dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Më 7 nëntor 2022, drejtori i MKP-së mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, në bashkëpunim me Komitetin Holandez të Helsinkit, me temën: *“Drejtësia restauruese dhe masat disiplinore”*.

Më 8 nëntor 2022, zëvendësi i Avokatit të Popullit realizoi takim me udhëheqësin e Departamentit për Politika Sociale dhe i Familjes (DPSF), ku u diskutua lidhur me dhënien e licencave shtëpive për të moshuar dhe monitorimin e tyre nga MFPT-ja, pas licencimit.

Më 9 nëntor 2022, zëvendësi i Avokatit të Popullit u prononcua për RTK-në, lidhur me trajtimin e të moshuarve nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Më 10 nëntor 2022, Avokati i Popullit bashkë me drejtorin e MKP-së pritën në takim 9 përfaqësues të Odës së Avokatëve nga Norvegjia.

Më 11 nëntor 2022, ekipi i MKP-së u takua me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar (ICRC), për të diskutuar mundësinë e bashkëpunimit, respektivisht realizimin e vizitave të qytetarëve të Kosovës që gjenden në burgjet e Serbisë.

Më 14 dhe më 15 nëntor 2022, Shërbimi Korrektues i Kosovës, me përkrahjen e OSBE-së, organizoi punëtorinë për hartimin e draftit për Udhëzimin Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese dhe Projekt-Udhëzimin Administrativ për punësimin e të dënuarve, pezullimin dhe lirin nga puna të të dënuarve.

Më 15 nëntor 2022, Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve (DRPRIH), në koordinim të ngushtë me Zyrën e Shefit të Misionit të UNHCR-së në Prishtinë dhe Programin për të drejtat civile në Kosovë (CRP/K), organizuan tryezë me temën: *“Integrimi Social e Ekonomik i Personave me Mbrojtje Ndërkombëtare”*.

Më 15 nëntor 2022, zëvendësi i Avokatit të Popullit mori pjesë në takim me grupet e marginalizuara në komunën e Gjilanit, ku u prezantua roli i Avokatit të Popullit dhe pjesëmarrja në diskutime me komunitetet joshumicë në këtë komunë, në lidhje me të drejtat e njeriut dhe bashkëpunimin e IAP-së me zyrtarët komunalë dhe me shoqërinë civile.

Më 17 nëntor 2022, zëvendësi i Avokatit të Popullit realizoi takim me ministren e Drejtësisë dhe me zëvendësministrin e Drejtësisë, lidhur me vizitën në Kosovë të delegacionit të IAP-së së Maqedonisë së Veriut.

Më 18 nëntor 2022, zëvendësi i Avokatit të Popullit mori pjesë në Kuvendin Komunal të Gjilanit, takim me tri grupe fëmijësh nga komuna e Gjilanit, në

Ditën Universale për të Drejtat e Fëmijëve, me ç’ rast u prezantua roli i IAP-së në përfaqësimin e të drejtave të fëmijëve.

Më 22 nëntor 2022, zëvendësi i Avokatit të Popullit dhe drejtori i MKP-së morën pjesë në lansimin e projektit: *“Përmirësimi i trajtimit për personat e privuar nga liria”*, që implementohet nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë.

Më 22 nëntor 2022, drejtori i MKP-së mori pjesë në Komitetin Drejtues, si anëtar i ekipit, ku u prezantua plani i aktiviteteve të projektit për periudhën 6-mujore.

Më 29 nëntor 2022, zëvendësi i Avokatit të Popullit dhe drejtori i MKP-së realizuan takim me zëvendësen e Avokatit të Popullit të Maqedonisë së Veriut dhe delegacionin e IAP-së së Maqedonisë, së bashku me drejtorin e ShKK-së dhe me koordinatorin e DShB-së, nga MSh-ja.

Më 30 nëntor 2022, stafi i MKP-së, së bashku me delegacionin nga Maqedonia e Veriut, realizuan vizitë në Institutin Special në Shtime dhe në Qendrën e Azilit në Magure.

Më 5 dhjetor 2022, zëvendësi i Avokatit të Popullit mori pjesë në lansimin e “Protokollit Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale”, organizuar nga Ministria e Drejtësisë.

Më 12 dhjetor 2022, zëvendësi i Avokatit të Popullit mori pjesë në Mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në të cilën morën pjesë aktorët më të lartë të sigurisë në komunën e Kamenicës. Andaj edhe si pikë e veçantë e rendit të ditës ka qenë: *“Promovimi dhe Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut”*.

Më 13 dhjetor 2022, zëvendësi i Avokatit të Popullit u prononcua për KTV-në në emisionin “Tempus”, lidhur me temën se sa respektohen liritë dhe të drejtat e njeriut në Kosovë.

Më 15 dhjetor 2022, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, në bashkëpunim me Komitetin Holandez të Helsinkit, organizuan tryezë diskutimi me temë: *“Rehabilitimi dhe riintegrimi i të miturve në konflikt me ligjin: perspektiva e pas-lirimit”*.

Më 14 dhjetor 2022, Avokati i Popullit së bashku me drejtorin e MKP-së, pritën në takim drejtorin e Shëndetësisë në Burgje, zëvendësrektorin e përgjithshëm të Shërbimit Korrektues dhe drejtoreshën e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (MKRMT), për të diskutuar për Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe qasjen e QKRMT-së në institucionet ku mbahen personat e privuar nga liria.

Trajnimet për MKP-në gjatë vitit 2022

Në kuadër të projektit të përbashkët të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, si dhe me përkrahjen e projektit të IPA-së, kanë vazhduar trajnimet edhe gjatë vitit 2022, për forcimin e kapaciteteve të MKP-së.

Në kuadër të projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, si dhe me mbështetjen edhe të Zyrës së UNHCR-së në Strasburg, përfaqësues nga MKP-ja, nga data 28 shkurt deri më 6 prill 2022, ndoqën kursin online të HELP-it, me temë: *“Azili dhe të Drejtat e njeriut”*, i cili mbulon në mënyrë interaktive konceptet kyçe, kornizën ligjore ndërkombëtare dhe evropiane (OKB, KiE, dhe BE), lidhur me azilin dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) dhe të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GjDBE).

Më 23 dhe më 24 mars 2022, anëtarët e MKP-së morën pjesë në Trajnimin për Prokurim dhe E-Prokurim, i organizuar nga projekti i IPA-së, me mbështetje të IAP-së.

Më 28 dhe më 29 mars 2022, përfaqësues nga MKP-ja morën pjesë në trajnimin e organizuar nga IPA, me temë: *“Mbrojtja nga Diskriminimi sipas KEDNj”*.

Më 28 dhe më 29 prill 2022, përfaqësues nga MKP-ja morën pjesë në trajnimin e organizuar nga IPA, me temë: *“Qasja në Drejtësi sipas KEDNj-së”*.

Më 4 dhe më 5 maj 2022, organizuar nga IPA, anëtarët e MKP-së morën pjesë në trajnimin me temë: *“Trajnimi për Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*.

Më 24 maj 2022, përfaqësues nga MKP-ja morën pjesë në trajnimin, me temë: *“Të drejtat pronësore”*, mbështetur nga projekti i BE-së.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i MKP-së 2022

Edhe gjatë vitit 2022, MKP-ja ka vazhduar bashkëpunimin ndërkombëtar, duke marrë pjesë në takime, trajnime, konferenca, si dhe në kurse virtuale të organizuara nga Rrjeti i MKP-ve i Evropës Juglindore, në Grupin Punues për Azil dhe Migrim të Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHR), nga IPA, si dhe nga Këshilli i Evropës.

Po ashtu, MKP-ja ka vazhduar bashkëpunimin me organizatat relevante ndërkombëtare, duke pasur shkëmbim të vazhdueshëm informatash, duke raportuar kohë pas kohe për gjendjen e të drejtave të njeriut, lidhur me gjendjen e personave të privuar nga liria dhe me çështjet që kanë të bëjnë me azilin dhe migrimin.

Në kuadër të këtyre bashkëpunimeve, më 4 shkurt 2022, përfaqësues nga MKP-ja realizuan takim virtual me homologun danez, ku takimi kishte për qëllim shkëmbimin e informatave lidhur me marrëveshjen ndërmjet Kosovës dhe Danimarkës

për me akomodimin në Kosovë të të burgosurve nga Danimarka.

Gjatë këtij viti, organizuar nga projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe i Këshillit të Evropës, me mbështetjen edhe të Zyrës së UNHCR-së në Strasburg, përfaqësues nga MKP-ja ndoqën kursin online, me temë: *“Azili dhe të Drejtat e njeriut”*.

Më 30 mars 2022, Avokati i Popullit, si dhe përfaqësues nga MKP-ja, realizuan takim me një delegacion nga FRONTEX-i (Fundamental Rights Officer). Fokusi i këtij takimi kishte të bënte me çështjet që lidhen me menaxhimin e kufirit.

Më 31 mars 2022, përfaqësuesi nga MKP-ja mori pjesë në takimin online të organizuar nga ENNHRI (Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut). Tema kryesore, ndër të tjera, ishte “IKDNj nën kërcënim-Ukraina”, duke u fokusuar në gjendjen shumë të rëndë me të cilën po përballlet Komisionarja Parlamentare e Ukrainës për të kryer detyrën e saj, si dhe çështje të migrimit dhe azilit, me fokus te situata në Ukrainë.

Më 22 prill 2022, MKP-ja priti në takim ekspertin e EKOJUST-it, me të cilën u diskutuan aspekte të ndryshme lidhur me situatën e të burgosurave në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan.

Më 20 deri më 23 qershor 2022, përfaqësues nga MKP-ja morën pjesë në takimin e organizuar nga Rrjeti i Mekanizmave Ndërkombëtar të Evropës Juglindore në Vjenë -Austri, me temë: *“Nevojat e veçanta të të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara fizike në vendet e ndalimit” dhe “Marrëdhënia e MKP-së me publikun”*.

Më 7 deri më 9 shtator 2022, përfaqësuesja e MKP-së mori pjesë në trajnimin e organizuar nga OSCE-ja dhe Office for Democratic Institutions and Human Rights (ODIHR), në Varshavë – Poloni, lidhur me: *“Integritetin e Çështjes së Dhunës Seksuale dhe asaj me bazë gjinore në monitorimin e vendeve të privuar nga liria”*.

Më 29 shtator 2022, MKP-ja realizoi takim me ekspertë të BE-së, ku u prezantua mandati, puna dhe sfidat e MKP-së.

Më 5 deri më 6 tetor 2022, zëvendësi i Avokatit të Popullit dhe drejtori i MKP-së morën pjesë në Konferencën e NPM-ve Evropiane në Strasburg – Francë, organizuar nga Këshilli i Evropës. Fokusi i kësaj konference ishte monitorimi i të drejtave të grupeve specifike të njerëzve të privuar nga liria, si: gra, fëmijë, të moshuar, migrantë etj.

Më 14 deri më 16 nëntor 2022, përfaqësues nga MKP-ja morën pjesë në takimin e dytë të organizuar nga Rrjeti i Mekanizmave Ndërkombëtar të Evropës Juglindore në Vjenë -Austri, me temë: *“Akomodimi dhe trajtimi i fëmijëve dhe adoleshentëve me probleme të shëndetit mendor dhe aftësi të kufizuara mendore dhe fizike” dhe “Aplikimi i masave shtrënguese ndaj të miturve dhe personave me çrregullime mendore”*.

Më 15 dhe më 16 nëntor 2022, përfaqësuesja nga MKP-ja mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga IOM-i dhe UNMIK-u, në Shkup, lidhur me përdorimin e gjuhëve.

RAPORT VJETOR I MEKANIZMIT
KOMBËTAR PËR PARANDALIM
TË TORTURËS

Nr. 6

